

# THE KOSOVO BANKER

**Financimi i Banimit:**  
Faktor i rëndësishëm  
për zhvillim  
socio-ekonomik  
në Kosovë

# A·U·K TRAINING & DEVELOPMENT INSTITUTE

Depending on your area of responsibility, you will be able to find courses and training that can help you and/or your company improve and develop professionally.



[www.auk.org/tdi](http://www.auk.org/tdi)


049 774 112  
038 608 608 ext. 608



[auki@auk.org](mailto:auki@auk.org)



+386 49 774 112




*Up until now A.U.K. Training and Development Institute has trained more than 20,000 candidates.*





# THE KOSOVO BANKER



## IMPRESSUM

### BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS



**Z. Ilir I. Aliu**  
Kryetar i Bordit,  
ProCredit Bank



**Z. Robert Wright**  
Zv. Kryetar i Bordit,  
Raiffeisen Bank



**Z. Abdurrahman Balkiz**  
Banka Kombëtare  
Tregtare



**Z. Alper Karakoç**  
IS Bank



**Z. Arton Celina**  
Banka për Biznes



**Z. Ayhan Albeyoğlu**  
TEB Bank



**Z. Lavdim Koshutova**  
NLB Prishtina



**Znj. Merita  
Gjyshinca-Peja**  
Banka Ekonomike



**Z. Meriton Sunduri**  
Ziraat Bank

### DREJTOR EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS DHE KRYEREDAKTOR

**Z. Petrit Balija**

### REDAKTORE

**Znj. Miranda Rugovaj**  
Zyrtare e Administratës dhe  
Komunikimit



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

### Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)

është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platform të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe influencen iniciativat ligjore dhe rregullative; bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për trajnime Bankare, e cila ofron trajnime në fushën e bankave dhe të financave.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy here në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejes p.n, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; [www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com); [contact@bankassoc-kos.com](mailto:contact@bankassoc-kos.com).

THE KOSOVO BANKER  
MBËSHKETET NGA  
FONDI EVROPIAN PËR  
EVROPËN JUGLINDORE



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE  
DEVELOPMENT FACILITY

# PËRMBAJTJA

## EDITORIALI 1

### SEKTORI FINANCIAR 2-15

- Intervistë me z. Robert Wright nënkryetar i Bordit të Drejtorëve në Shoqatën e Bankave dhe CEO i Raiffeisen Bank
- Pronësia e banimit dhe përfitimet socio-ekonomike -Dafina Dobroshi Kabashi -ProCredit Bank
- Roli i financimit të banimit në zhvillimin shoqëror-Jehona Oruqi - Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
- Roli i bankave në vendimin e qytetarëve për të blerë shtëpi banimi -Driton Hetemi -ProCredit Bank
- Politikat mbi menaxhimin e riskut nga produktet dhe shërbimet e reja - Naser Krasniqi - Banka për Biznes

### FJALA E ANËTARIT TË RI TË BORDIT TË SHBK-SË DHE KRYESHEFIT TË RI EKZEKUTIV TË BPB-SË 16

### KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR 17-21

- Ndryshimet në kartëmonedha të paraqitura nga Banka Qendrore Evropiane
- Cili është dallimi në mes të normes nominale dhe reale të interesit?
- Karakteristikat kryesore të kartelave të kreditit
- Karakteristikat e E-banking

### LAJMET E SHBK-së 22-31

- U mbajt Forumi i Hapur: Sektori bankar dhe sistemi i zbatimit të kontratave në Kosovë
- Sistemi bankar në Kosovë, stabil
- Luksemburgu mbështet zhvillimin e sektorit bankar në Kosovë
- Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive diskutohet në Shoqatën e Bankave të Kosovës

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, takoi Shoqatën e Bankave të Kosovës
- Shoqata e Bankave të Kosovës merr pjesë në konferencën "Financimi i Kontratave dhe Eficienca në Pagesa në tregun e Kosovës"
- Java Ndërkombëtare e Parasë 2016 "Merr pjesë, kurse në mënyrë të mençur!" (Take part, save smart!)
- Shoqata e Bankave të Kosovës dhe IFC-ja i bashkojnë përpjekjet për t'i përforcuar Institucionet Financiare dhe për ta Inkurajuar Inovacionin
- Shoqata e Bankave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosoves diskutuan mbi progresin e arritur në implementimin e standardeve të Bazel-it
- SHBK merr pjesë në punimet e Konferencës Rajonale "Iniciativa për implementimin e shtyllës së dytë të kornizës rregullative të Basel-it: ICAAP/SREP dhe shembujt praktik"

### LAJME NGA BANKAT DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE 32-35

- Banka Ekonomike vazhdon me seminarët e Edukimit Financiar për klientë
- JCR Eurasia Rating rivlerëson BKT me AAA për të tetën herë radhazi
- BPB mëson fëmijët mbi kursimet dhe vlerën e parasë
- NLB Banka përkrahë financiarisht renovimin në dy kate në Spitalin e Pediatrisë
- Banka ProCredit edhe këtë vit mbështetëse e DOKUFEST
- Euromoney: Raiffeisen, Banka më e mirë në Kosovë
- TEB Sh. A. Banka më e mirë në Kosovë nga Global Finance

Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). SHBK dhe EFSE nuk mbajnë përgjegjësi mbi përmbajtjen e artikujve të autorëve të publikuar në revistën "The Kosovo Banker".





## Dr. sc. PETRIT BALIJA

DREJTOR EKZEKUTIV  
SHOQATA E BANKAVE  
TË KOSOVËS

### Të nderuar lexues,

Mirësevini në edicionin e 9-të të revistës "The Kosovo Banker". Kam kënaqësinë të ndajë me ju këtë botim të ri i cili shqyrton një temë me interes të veçant për secilin nga ne dhe për ekonominë e vendit tonë "Financimi i Banimit: Faktor i Rëndësishëm për Zhvillimin Socio-Ekonomik në Kosovë".

Një ndër sfidat kryesore i cili paraqet njëkohësisht edhe investimin kryesorë të jetës për secilin nga ne është investimi në një pronë të përshtatshme dhe të sigurtë për banim. Ky investim mund të arrihet në mënyra të ndryshme përfshi këtu edhe shfrytëzimin e mjeteve të kursyera vetanake, gjenerimi i mjeteve financiare nga shitja e ndonjë prone të poseduar më herët, ndihma financiare nga familjaret apo edhe remitencat nga të afërmit në diasporë. Megjithatë, shpeshherë këto mjete mund të mos i kemi në dispozicion apo edhe mund të mos mjaftojnë dhe si rezultat kemi nevojë për të financuar banimin përmes kredive bankare. Një prej produkteve kryesore financiare të bankave është edhe kredia hipotekare për financimin e banimit e cila nuk është e shfrytëzueshme në nivel të kënaqshëm për disa arsye të cilat synojmë ti trajtojmë në këtë edicion në mënyrë që të ngjallim debatin rreth kësaj teme për të aktivizuar të gjithë akterët relevant për të rritur kreditimin, lehtësuar procedurat dhe përmirësuar kushtet për financimin e banimit në Kosovë përmes kredive hipotekare rezidenciale.

Deri në vitet e fundit ka munguar një pjesë e legjislacionit i cili është i domosdoshëm për të mundësuar financimin e banimit me kushte më të favorshme dhe kjo mungesë është plotësuar së fundmi me hyrjen në fuqi në Janar të vitit 2016 të Rregullores për Kreditë Hipotekare Residenciale të draftuara dhe të aprovuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesorë i kësaj rregulloreje është që të vendosë kërkesat dhe standardet për kreditë ndaj personave fizik, të siguruara përmes pronës së paluajtshme rezidenciale për qëllime banimi. Përmes kësaj

rregulloreje përcaktohen kushtet për ofrimin e kredive rezidenciale më të favorshme për personat fizikë, të cilat përmbushin kriteret sipas kësaj rregulloreje. Këtu përfshihet procesi i aplikimit, kreditimit, financimit dhe servisimit të kredive hipotekare rezidenciale.

Përkundër kësaj arritjeje të rëndësishme mbeten ende një numër i ngecjeve në hallkat tjera të këtij procesi për financimin e banimit të cilat janë adresuar në këtë numër të revistës dhe të cilat shpresojmë të jenë me interes për lexuesit. Për më shumë, në këtë numër kemi edhe një intervistë të veçantë me z. Robert Wright, Nënkryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, njëherit edhe Kryeshef Ekzekutive në Raiffaisen Bank Kosovo i cili ka treguar një interesim të veçantë në këtë temë për vite me radhë ku do të na shpalos disa nga opinionet e tij për këtë çështje. Në këtë numër është përfshirë edhe një fjalë njoftuese për anëtarin më të ri të bordit të Shoqatës së Bankave z. Arton Celina i cili së fundmi ka marrë përsipër udhëheqjen dhe drejtimin e Bankës për Biznes si Kryeshef Ekzekutiv. Poashtu, në këtë numër mund të gjeni edhe këndin e edukimit financiar ku mund të merrni informacione të reja në fushën e financave si dhe informacione tjera në lidhje me ngjarjet më të rëndësishme në sektorin bankar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.

Shfrytëzoj këtë rast për të falenderuar bankat anëtare të SHBK-së dhe Fondin Europioan për Europën Juglindore (EFSE) për sponsorimin e këtij edicioni dhe një falenderim të veçant autorëve dhe stafit të SHBK-së që kontribuan në përgatitjen e këtij edicioni. Gjithashtu, pa harruar asnjëher, falenderoj lexuesit tanë të devotëshëm për ndjekjen e të gjitha publikimeve tona përgjatë viteve.

Sinqerisht,

*Petrit Balijs*

# Intervistë me Z. Robert Wright

## Nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës, CEO i Raiffeisen Bank

**SHBK:** Cili është mendimi juaj në lidhje me zhvillimin e përgjithshëm të tregut të hipotekave në Kosovë dhe cila është rëndësia e këtij tregu për ekonominë e Kosovës?

**Z. Wright:** Preferoj të flas për zhvillimin e tregut të pronësisë së shtëpive në Kosovë më shumë se për tregun e hipotekave, pasi që hipotekat janë vetëm një pjesë e procesit. Megjithatë, për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj në veçanti, unë jam i zhgënjyer me zhvillimin e tregut privat individual hipotekar në Kosovë. Ka pasur shumë diskutime, seminare, forume, dhe plane të bëra gjatë viteve të fundit, por portofolio hipotekare në Kosovë mbetet e vogël dhe është rritur vetëm nga 44 milion në 67 milion Euro në 5 vitet e fundit.

Pronësia e shtëpive është e një rëndësie të madhe për ekonominë e Kosovës. Përveç gjenerimit të pasurisë dhe mundësive të huamarrjes të krijuara nga pronësia e një mjeti të vlerësuar, blerja e një prone krijon vlerë dhe rrjedhje të hollash përgjatë një zinxhiri furnizimi të konsiderueshëm të furnizuesve të materialit ndërtimorë, shitësve të mobilie, kompanive të mirëmbajtjes, elektrikistëve, hidraulikëve, etj.

Larry Summers ish-sekretari amerikan i Thesarit tha se "askush nuk pastron kurrë një makinë me qira" dhe unë mendoj se kjo është shumë relevante për pronësinë e shtëpive. Nëse ju posedoni një pronë ju kujdeseni më shumë për cilësinë e mjedisit tuaj të jetesës dhe jeni të gatshëm të investoni në mirëmbajtjen dhe ruajtjen e pronës dhe mjedisit përreth.

**SHBK:** Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballlet financimi i pronësisë së shtëpive në Kosovë?

**Z. Wright:** Ka disa sfida! Mendoj që përballeshmëria është një problem i madh. Një çmim prej 700 - 1000 Euro për metër katror për një apartament në Prishtinë në krahasim me pagën mesatare në Kosovë prej rreth 400 Euro në muaj bën posedimin e pronës një sfidë të vështirë. Bankat tani janë duke ofruar kredi për 25 vjet deri në 90% të vlerës së pasurisë me normë interesi rreth 6% e

### Z. ROBERT WRIGHT

NËNKRYETAR I BORDIT  
TË DREJTORËVE TË  
SHOQATËS SË BANKAVE  
TË KOSOVËS,

CEO, RAIFFEISEN  
BANK KOSOVO



cila ndihmon huamarrësit potencial, por deponimi fillestar në pronë dhe pagesat mujore për hipotekë janë ende një sfidë.

Sfida të tjera përfshijnë proceset e komplikuar të administrimit përmes Zyrave Kadastrale, koha e gjatë për pranimin teknik të ndërtimeve të reja, regjistrimi i pengut hipotekar dhe certifikimi i pronësisë. Sigurimi dhe besimi tek sistemi ligjor në rastet që përfshijnë riposedimin e pronës hipotekare dhe aftësia e bankës për të rimarrë borxhet e tyre me shitjen e një prone të riposeduar me një çmim të barabartë me borxhin hipotekar janë poashtu sfida.

**SHBK:** Çfarë mendoni në lidhje me zhvillimin e tregut të hipotekave në Kosovë në krahasim me rajonin, si dhe vendet e BE-së?

**Z. Wright:** Madhësia e tregut privat individual hipotekar të Kosovës krahasohet dobët me vendet fqinje dhe edhe më shumë me vendet e BE-së. Edhe pse të dhënat në lidhje me portofolion për hipotekat residenciale në rajon nuk janë në dispozicion dhe për këtë arsye është vështirë të bëhet një krahasim, Kosova konsiderohet se ka një portofolio relativisht të vogël për hipotekat residenciale dhe familjet kanë tendencë që të kenë një përqindje relativisht të ulët të borxhit për hipotekë residenciale në raport ndaj totalit të borxhit të tyre familjar, ky është një indikator që tregon se ka hapësirë të konsiderueshme për rritje të kreditimit për hipotekat residenciale.

**Pronësia e shtëpive është e një rëndësie të madhe për ekonominë e Kosovës. Përveç gjenerimit të pasurisë dhe mundësive të huamarrjes të krijuara nga pronësia e një mjeti të vlerësuar, blerja e një prone krijon vlerë dhe rrjedhje të hollash përgjatë një zinxhiri furnizimi të konsiderueshëm të furnizuesve të materialit ndërtimorë, shitësve të mobilieve, kompanive të mirëmbajtjes, elektrikistëve, hidraulikëve, etj.**

**SHBK:** Cilat janë mundësitë kryesore për përmirësimin e pronësisë së shtëpive në Kosovë?

**Z. Wright:** Mendoj se i jam përgjigjur kësaj pyetjeje në pyetjet tjera

**SHBK:** A shihni një kërkesë të konsiderueshme për këtë lloj të kredive në Kosovë?

**Z. Wright:** Dëshira për të poseduar shtëpinë tuaj është padyshim e lartë në Kosovë, por kërkesa për kredi është e ulët duke pasur parasysh madhësinë e hipotekës së nevojshme dhe përballueshmërinë e pagesave (kësteve). Poashtu nuk ka mungesë të pronës në dispozicion për blerje kështu që furnizimi (oferta) nuk është problem, dhe në shumë mënyra ana e kërkesës në ekuacion nuk është një problem në kuptimin që ka një dëshirë të lartë të posedojnë një pronë, por problemi është aftësia për të përmbushur këtë dëshirë.

**SHBK:** A do të pajtoheshit se normat e interesit për financimin e pronësisë në shtëpi duhet të jenë dukshëm më të ulëta sesa normat mesatare të interesit?

**Z. Wright:** Po unë do të pajtohesha dhe ky është rasti në realitet. Jetëgjatësia dhe siguria e kredisë krijon një normë të ulët interesi. Norma mesatare e interesit për të gjitha kreditë private individuale në

sektorin bankar në Kosovë në Maj të vitit 2016 ishte rreth 7.5%, ndërsa normat e interesit për kreditë hipotekare ishin rreth 6.5%.

**SHBK:** A mendoni se portofolio kreditore hipotekare mund të ekspozon industrinë bankare ndaj rrezikut të mundshëm të tregut të pasurive të paluajtshme siq kemi parë në disa vende të tjera?

**Z. Wright:** Jo unë nuk mendoj se ka një rrezik serioz për disa arsye. Para së gjithash, industria bankare në Kosovë ka një histori të gjatë dhe të besueshme të kreditimit të ndjeshëm dhe ne kemi raportin më të ulët të kredive jo-performuese në rajon (KJP). Ne do të vazhdojmë të kemi këtë qasje të kujdesshme dhe të matur. Së dyti, shumë prej problemeve me kreditë hipotekare në vende të tjera kanë ndodhur për shkak të kreditimit në valutë të huaj, në veçanti me Franga Zvicëre, dhe nuk ka asnjë mënyrë që bankat në Kosovë të kreditojnë në ndonjë monedhë tjetër përveç Euros. Së treti, pronat e banueshme kanë provuar në mënyrë të vazhdueshme të jenë një pasuri me vlerë në rritje gjatë shumë viteve, kështu që bankat mund të jenë të sigurt se kreditimi është i siguar mirë dhe rreziku është i minimizuar.

**SHBK:** A mendoni se institucionet e Kosovës kanë bërë mjaft për të përmirësuar financimin e pronësisë për shtëpi dhe cilat janë rekomandimet tuaja për përmirësime të mëtejshme?

**Z. Wright:** Progres i mirë është arritur në vitet e fundit, për shembull ndryshimet pozitive në rregulloret e Bankës Qendrore, përmirësimet e bankave në produktet hipotekare dhe përafrimi i pronës dhe menaxhimit të pronësisë me standardet e BE-së, por akoma më shumë duhet të bëhet. Unë mendoj se bankat mund të përmirësojnë ende produktet e tyre, për shembull për kredi për 30 vjet ose më shumë për të ulur pagesat mujore për huamarrësit dhe ndoshta huazimi deri në 90% apo edhe 95% të vlerës së pronës; por, për të bërë këtë ne kemi nevojë për besim më të madh në shpejtësinë dhe besueshmërinë e procesit ligjor për kthimin e kredive jo-performuese. Unë gjithashtu besoj se qeveria mund të bëjë më shumë për t'i mundësuar blerësit për herë të parë të hyjnë në treg me disa iniciativave për zbutjen e rrezikut për huadhënësit për shembull garanci për 100% të hipotekës, dhe stimuj për ndërtuesit, të tilla si përfitimet tatimore dhe rishikimet e disa prej kushteve rregullative. Një tjetër faktor i rëndësishëm për rritjen e hipotekave dhe rritjen e pronësisë në shtëpi është pika që përmenda më parë, përballueshmëria e pronës dhe ulja e marzhit të fitimit aktualisht e përfituar nga ndërtuesit.

# Pronësia e banimit dhe përfitimet socio-ekonomike

*Financimi i banimit – pronësia ka ndikime pozitive jo vetëm për pronarët e shtëpive mirëpo rrjethimisht mund të ketë benefite edhe për komunitete. Si i tillë, kontributi në komunitete shfaqet në disa mënyra pasiqë pronarët, në krahasim me qeramarrësit, janë të dedikuar dhe të lidhur me pronat e tyre. Së pari, pronarët në krahasim me qeramarrësit shpërngulen më rrallë dhe janë të vendosur në pronat e tyre në mënyre afagjate.*

Sektori i financimit kredive hipotekare është pjesë integrale e zhvillimit ekonomik dhe social. Studimet vazhdimisht tregojnë për rëndësinë e zhvillimit të sektorit të banimit në ekonomi si dhe benefitet sociale afatgjata. Përveç përfitimeve financiare, pronësia sjellë përfitime të konsiderueshme sociale për familjet, komunitetet dhe vendin në tërësi. Në shumicën e vendeve në zhvillim, banimi përfaqëson një pjesë të madhe të shpenzimeve familjare dhe merr një pjesë të konsiderueshme të ardhurave të jetës. Për të kursyer apo për të siguruar një shumë të konsiderueshme të mjeteve për blerje të pronës për banim është vështirë të arrihet dhe mund të jetë privilegj vetëm për një numër të caktuar të popullatës. Për këtë arsye, financimi i banimit është i rëndësishëm për të mundësuar blerjen e pronës për banim për një pjesë të popullatës të cilët i përmbushin kushtet minimale të kredimarrjes. Si i tillë, financimi i

## DAFINA DOBROSHI-KABASHI

UDHËHEQËSE E  
RREZIKUT OPERACIONAL  
DEPARTAMENTI I  
MENAXHIMIT TË RREZIKUT  
PROCREDIT BANK  
KOSOVA



banimit resulton në një numër të benefiteve sociale dhe ekonomike. Disa nga përfitimet e pronësisë së banimit janë të theksuara në literaturë dhe studime empirike, sic janë, por jo të limituara në: stabilitetin social, zhvillim të shoqërisë civile, zvogëlimin e krimit, rritjen e përgjithshme e mirëqenies sociale, etj. Pronarët e shtëpive akumulojnë pasuri ashtu siç rritet vlera e shtëpisë së tyre, janë më të involvuar në komunitete dhe sipas studimeve të ndryshme fëmijët e pronarëve tregohen më të sukseseshëm akademikisht dhe kanë më pak gjasa të involvohen në krime<sup>1</sup>.

Financimi i banimit – pronësia ka ndikime pozitive jo vetëm për pronarët e shtëpive mirëpo rrjethimisht mund të ketë benefite edhe për komunitete. Si i tillë, kontributi në komunitete shfaqet në disa mënyra pasiqë pronarët, në krahasim me qeramarrësit, janë të dedikuar dhe të lidhur me pronat e tyre. Së pari, pronarët në krahasim me qeramarrësit shpërngulen më rrallë dhe janë të vendosur në pronat e tyre në mënyre afagjate. Si rezultat (pronarët) investojnë më tepër në pronat e tyre, lagjet dhe indirekt në komunitetet e tyre dhe si

1 Glaeser, E. and B. Sacerdote. 1999. "Pse ka më tepër krime në qytete?" Journal of Political Economy 107: pp. s225-s258.



të tillë pronarët e shtëpive kanë ndikim më të madh financiar në lagjet e tyre në krahasim me qeramarrësit. Poashtu, komunitetet përfitojnë nga taksat e pronave të cilat paguhen nga pronarët e shtëpive dhe kontribuojnë që të kenë lagje stabile. (Departamenti i Zhvillimit Urbanistik të Shteteve Të Bashkuara 2000).

Pronarët poashtu i korrin përfitimet financiare të çdo vlerësimi të pronës së tyre – shtëpisë kështu që ata gjithashtu kanë tendencë për të shpenzuar më shumë kohë dhe para duke e mirëmbajtur vendbanimin e tyre, e cila gjithashtu kontribuon në cilësinë e përgjithshme të komuniteteve të tyre. Studimet poashtu tregojnë për arritje më të theksuar akademike tek fëmijët e pronarëve. Boehm dhe Schlottmann<sup>2</sup> tregojnë se fëmijët e pronarëve të shtëpive kanë më shumë gjasa për të arritur një nivel më të lartë të arsimit dhe, në këtë mënyrë, një nivel më të lartë të të ardhurave e cila poashtu rritë probabilitetin që fëmijët prindërit e të cilëve kanë pronësi kanë probabilitet të më të lartë që të jenë pronar në të ardhmën.

Përveç tjerash, financimi i banimit ka efekt pozitiv pasi që stimulon një kulturë të kursimeve dhe rrjedhimisht minimizon nevojën për kredi dhe shprehi konsumuese. Kursimi në kontekstin e financimit të pronës është i rëndësishëm sepse ndihmon qysh në fillim për pagesa minimale e kredisë (downpayment). Sipas Thomas Shapiro of Brandeis University, argumenti kryesor për pronësi të shtëpisë është se ajo është mënyra më e rëndësishme se si familjet akumulojnë pasuri. Përveç nxitjes së kursimeve, normat e interesit për financim të banimit kanë tendencë të jenë më të favorshme se çdo formë tjetër e huamarrjes në treg dhe rrjedhimisht pagesa për këtë lloj financimi është më e përballeshme dhe është afatgjatë për familjet.

Përveç faktorëve të përmendur më lartë, investimet në industrinë e ndërtimit stimulojnë ekonominë dhe gjenerojnë vende të reja pune. Pasi që një pjesë e konsiderueshme e të hyrave

të gjeneruara kthehen/kontribuojnë në ekonomi, efekti shumëzues (multiplier effect) është më i lartë në industrinë e ndërtimit në krahasim me tjerat. Ndërtimtaria, mirëmbajtja e shtëpive, rryma dhe transporti kanë ndikim shtesë dhe direkt në ekonomi dhe të gjitha këto ndikojnë poashtu në gjenerim të vendeve të punës.

Si përfundim, financimi i pronës së banimit sjellë përfitime sociale dhe ekonomike. Pronësia (e banimit) mundëson autonomi individuale dhe është aspiratë e shumicës së familjeve. Pronësia e banimit i mundëson familjeve që të akumulojnë pasuri dhe një status social dhe poashtu sjellë përfitime tjera siç janë ato sociale, ekonomike dhe civile. Gjithashtu, pronësia kërkon përgjegjësi më të madhe individuale. Pronësia konsiderohet si një ndër shpenzimet më të mëdha financiare të jetës së një familje. Prandaj, investimi në pronësi, në shumicën e kohës me financim, është një angazhim afat-gjatë dhe si rezultat mund të ndryshojnë sjelljen e njeriut duke duke marre më tepër përgjegjësi individuale dhe kolektive.



<sup>2</sup> Boehm, Thomas P.; Schlottmann, Alan M. A ka ndikim ekonomik pronësia e prindërve tek fëmijët? Journal of Housing Economics, Sept. 1999. Vol. 8, Iss. 3, faqe 217-232.

# Roli i financimit të banimit në zhvillimin shoqëror

*Financimi i banimit luan rol kritik në zhvillimin socio-ekonomik sepse ndikon në forma të ndryshme në ekonomitë familjare. Mbi të gjitha ndikon drejtpërdrejt në krijimin e një standardi më të mirë të jetesës, sidomos për grupe të caktuara të shoqërisë që e kanë pothuaj të pamundur të sigurojnë investimet fillestare. Duke aplikuar interesa me kushte speciale për këto grupe shoqërore, bankat do të mundësojnë integrimin e tyre në shoqëri.*

Sigurimi i banimit është një nga nevojat genësore të njerëzimit dhe si i tillë reflektohet edhe nga sektori bankar përmes produkteve dhe shërbimeve të ofruara. Financimi i banimit paraqet rëndësi të veçantë për ekonomitë familjare, zhvillimin socio-ekonomik, dhe ekonominë e vendit në përgjithësi. Në Kosovë kohën e fundit është rritur kërkesa për një shërbim të tillë dhe sistemi bankar po i përgjigjet pozitivisht përmes lehtësimit të standardeve të aplikuara. E gjithë kjo gradualisht po ndikon në eko-sistemin financiar, mirëqenien e ekonomive familjare, dhe industrive të ndryshme që ndërlidhen me banimin.

Financimi i banimit luan rol kritik në zhvillimin socio-ekonomik sepse ndikon në forma të ndryshme në ekonomitë familjare. Mbi të gjitha ndikon drejtpërdrejt në krijimin e një standardi më të mirë të jetesës, sidomos për grupe të caktuara të shoqërisë që e kanë pothuaj të pamundur të sigurojnë investimet fillestare. Duke aplikuar interesa me kushte

## **JEHONA ORUQI**

MENAXHERE E  
DEPARTAMENTIT PËR  
KREDI INDIVIDUALE

DEPARTAMENTI I  
KREDIVE INDIVIDUALE

BANKA KOMBËTARE  
TREGTARE-BKT



speciale për këto grupe shoqërore, bankat do të mundësojnë integrimin e tyre në shoqëri. Ndër të tjera është e evidente se me përmirësimin e kushteve të banimit, krijohen edhe shumë parakushte tjera që ndikojnë në faktorët fizik dhe psikologjik të forcës potenciale prodhuese në ekonomi. Familjet me përmirësimin e ambientit të banimit krijojnë mundësi më të mira për antarët e tyre, dhe kështu ngrisin nivelin e mirëqenies dhe edukimit adekuat që ndikon në zhvillimin më të mirë të forcës punëtore.

Banimi kërkon planifikim afatgjatë financiar familjar dhe kjo ndikon edhe në rritjen e kursimeve. Ndonjëherë këto kursime referohen edhe si “kursime të detyruara” pasi që në rast të financimit të banimit familjet janë të detyruara të kursejnë. Në rrethana tjera ndoshta këto kursime nuk do të ndodhnin sepse do të hynin drejtpërdrejt në konsum afatshkurtër i cili jo gjithmonë është i planifikuar racionalisht. Kuptohet kursimet ndoshta përkohësisht mund të pezullojnë konsumin, por në term afatgjatë mund të shëndrrohen në konsum në të ardhmen që mund të planifikohet më mirë. Financimi i banimit në të njëjtën kohë ndikon edhe në stabilizimin e ekonomive familjare,

pasi që mund të llogaritet edhe si investim afatgjatë i cili krijon pasuri dhe më vonë mund të përdoret si aset që gjeneron të hyra.

Gjithashtu industria e ndërtimit dhe banimit ka efekt të shumfishtë në ekonomi meqenëse ndërlihdë shumë sektor të tjerë komplementarë, si për shembull: sektori i drurit, pajisjeve të banimit, etj. Në Kosovë kjo industri aktualisht po kalon në fazën ku oferta është më e lartë se kërkesa dhe në këso periudha sektori bankar mund të luaj rol shumë të rëndësishëm për të balancuar situatën. Duke financuar banimin me norma të veçanta të interesit, bankat mund të stimulojnë kërkesën dhe kjo do të kishte efekt të dy anshëm: 1) sigurimin e vendeve të punës për punonjësit e kësaj industrie dhe 2) sigurimin e banimit ose përmirësimin e kushteve për blerësit potencial.

---

**Nëse i referohemi raporteve të BQK-së kërkesat e kredive për shtëpi kanë shënuar rritje të vazhdueshme krahasuar me vitet paraprake, ku në TM1 2016, vlera e kredive arriti në 2.07 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.8 përqind (4.3 përqind në TM1 2015), kjo rritje kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës për kredi si nga ekonomitë familjare ashtu edhe nga ndërmarrjet. Po ashtu, ndikim kishin edhe standardet dhe kushtet e kreditimit të aplikuara nga bankat, sidomos ulja e normave të interesit dhe zgjerimi i shumës së kredisë.**

---

Nëse i referohemi raporteve të BQK-së kërkesat e kredive për shtëpi kanë shënuar rritje të vazhdueshme krahasuar me vitet paraprake, ku në TM1 2016, vlera e kredive arriti në 2.07 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.8 përqind (4.3 përqind në TM1 2015), kjo rritje kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës për kredi si nga ekonomitë familjare ashtu edhe nga ndërmarrjet. Po ashtu, ndikim kishin edhe standardet dhe kushtet e kreditimit të aplikuara nga bankat, sidomos ulja e normave të interesit dhe zgjerimi i shumës së kredisë.

Zhvillimi i sektorit të kredive për banim ende vlerësohet në nivel relativisht të ulët në krahasim me vendet e zhvilluara por edhe ato të rajonit. Nga të dhënat e fundit në dispozicion vërehet se kreditë hipotekare në raport me produktin e brendshëm bruto arrijnë në rreth 5.5%, përderisa ky tregues në vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian është dukshëm më i lartë (rreth 20%).

Anë pozitive në këtë drejtim paraqet ecuria në rritjen e kredive hipotekare për banim, cilësia e mirë e tyre dhe ecuria e rënies së normave të interesit për këto kredi. Këto zhvillime pritet të ndikojnë pozitivisht duke mos harruar që ky sektor ka kapacitet mjaft të lartë për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm. Rrjedhimisht, për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të financimit të kredive për banim. Aktualisht në Kosovë është duke u punuar në sigurimin e një mjedisi më të favorshëm për financimin e banimit dhe për këtë janë duke punuar shumë palë të ndërlihdura. Për fund mund të themi se aktivitetet dhe politikat që po ndërmirren nga BQK-ja dhe bankat komerciale për të fuqizuar financimin e banimit janë në përputhje me rëndësinë socio-ekonomike të këtij sektori.





Verified by  
**VISA**

# ÇELËSI YT PERSONAL PËR TË SIGURUAR BLERJET ONLINE



## Banka TEB ofron blerje të sigurtë online me 3-D Secure.

3-D Secure ju mundëson të vërtetoni origjinalitetin e kartelës dhe transaksionin e blerjes online.

Për çdo transaksion online nga kredit kartela juaj të kryer në WEB faqet çertifikuara me 'Verified by VISA', ju do të pranoni çdo herë me SMS një fjalëkalim për të autorizuar transaksionin tuaj.

Kurseni kohë duke blerë online në mënyrë të sigurtë dhe të thjeshtë.

3-D secure, çelësi yt personal për të siguruar të gjitha blerjet online.

Për t'u siguruar që transaksioni juaj të jetë i suksesshëm duhet të keni të përditësuar numrin e telefonit, në rast se nuk e keni, atëherë ju rekomandojmë që ta vizitoni degën me të afërt.

Shpenzimet për shërbimin 3D Secure mbulohen nga banka, ndërsa konfirmimin me SMS aplikohen komisionet si më poshtë:

LLOJET E KOMISIONIT	KLIENTË AFARISTË	KLIENTË PRIVAT	VALIDITETI
3D Secure kodi një-përdorimësh për Blerjet online deri në 4.99€ me kredit kartelë	Pa pagesë	Pa pagesë	Për autorizim të transaksionit
3D Secure kodi një-përdorimësh për Blerjet online prej 5.00€ e me shumë me kredit kartelë	0.10 €	0.10 €	Për autorizim të transaksionit
3D Secure kodi një-përdorimësh për Blerjet online me Debit Kartelë	0.10 €	0.10 €	Për autorizim të transaksionit



# TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

teb-kos.com / 038 230 000

# Roli i bankave në vendimin e qytetarëve për të blerë shtëpi banimi

*Para vendimit për të investuar një shumë të konsiderueshme, konsumatorët financiarë kanë nevojë për këshillime dhe udhëzime rreth mundësive më të mira dhe më të volitshme të financimit. Në këtë mes, roli i bankës në këshillimin, udhëzimin dhe sqarimin rreth shërbimeve bankare kontraktuale, është i padiskutueshëm. Edukimi financiar në një masë të madhe mbetet barrë e institucioneve financiare, sidomos në vendet si Kosova, ku industria bankare është ndër më të zhvilluarat.*

Vendimi për të investuar në blerjen apo ndërtimin e një shtëpie për të jetuar, është padyshim ndër vendimet më të rëndësishme në jetën e gjithsecilit. Në këtë kontekst, bankat si pjesë e një prej industrive më të zhvilluara në vend, luajnë një rol të rëndësishëm në këto vendime investive. Para vendimit për të investuar një shumë të konsiderueshme, konsumatorët financiarë kanë nevojë për këshillime dhe udhëzime rreth mundësive më të mira dhe më të volitshme të financimit.

Marrë parasysh volatilitetin e tregut të punës në vend, bankat natyrisht janë të interesuara të identifikojnë klientët potencialë dhe t'i financojnë ata të cilët kanë të ardhura më stabile mujore. Në parim, klientët me të ardhura stabile mujore, do të jenë më në gjendje të bëjnë kthimin e kredisë sipas planit, që në fund për bankën do të thotë rrezik më i ulët kreditor dhe në fund profit më stabil. Sidoqoftë, unë mendoj që bankat duhet të jenë të interesuara jo vetëm

## **DRITON HETEMI**

DREJTUES I  
DEPARTAMENTIT TË  
BIZNESIT PËR KLIENTË  
PRIVATE

PROCREDIT BANK  
KOSOVA



ne aspektin kuantitativ dhe profitabil gjatë financimit të klientëve, mirëpo ato duhet të kenë një fokus të veçantë në aspektin kualitativ gjatë identifikimit të klientëve dhe nevojave të tyre, sepse bankat janë ato të cilat fuqishëm mund ta ngrisin nivelin e edukimit financiar në shoqëri, i cili jo vetëm ndihmon në zhvillim ekonomik, mirëpo edhe në mirëqenie sociale të gjithmbarshme.

Shikuar nga aspekti historik në këtë çështje, kriza e fundit ekonomike ka rrjedhur pikërisht nga tregu i patundshmërive, i stimuluar nga bankimi jo i përgjegjshëm me appetite të larta për profitabilitet afatshkurtër nga bankat, ndihmuar nga instrumente të komplikuara financiare. Kur them instrumente të komplikuara financiare, mendoj në aspektin e zhvillimit teknologjik dhe informativ gjatë dekadave të fundit, duke i dhënë secilit individ qasje në shërbime bankare. Mirëpo qasja në shërbime bankare, nuk do të thotë se secili konsumator do t'i kuptojë ato në nivelin e duhur sa për të marrë një vendim për të investuar. Në këtë mes, roli i bankës në këshillimin, udhëzimin dhe sqarimin rreth shërbimeve bankare kontraktuale, është i padiskutueshëm. Edukimi financiar në një masë të madhe mbetet barrë e institucioneve

financiare, sidomos në vendet si Kosova, ku industria bankare është ndër më të zhvilluarat. Andaj, gjatë diskutimit me klientë, banka luan një rol kyç jo vetëm në edukimin e tyre financiar, mirëpo edhe në vendimmarrjen e tyre për të investuar mençur.

Banka ProCredit, si institucion i orientuar fuqishëm ndaj zhvillimit të përgjithshëm, goftë ekonomik apo social, aplikon një kujdes të veçantë ndaj kreditimit të klientëve privatë. Kjo qasje është fuqishëm e lidhur me aspektin e kredive konsumuese, të cilat nuk duhet inkurajuar. Dekurajimi i kredive konsumuese nuk bëhet thjeshtë për arsye se ato nuk kontribuojnë në zhvillimin e mirëqenies sociale, mirëpo kreditimi i tillë e përkeqëson atë. Shikuar në këtë aspekt, banka ProCredit synon që të kontribuojë në zhvillimin e tregut të kredive hipotekare, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët e vendit. Kësisoj, është e domosdoshme që secili konsumator të analizohet individualisht rreth nevojave të tij, konform kapacitetit financiar për t'u kredituar në saje të të ardhurave stabile dhe të rregullta mujore, duke mos rënduar buxhetin familjar të nevojshëm për një mirëqenie përgjatë jetëgjatësisë së kredisë.

Për më tepër, zhvillimi i kreditimit të gjelbër mbetet ndër fokuset kryesore operative të bankës ProCredit. Në këtë kontekst, roli i bankës në këshillimin e klientëve për të bërë investime miqësore me ambientin, është i pakontestueshëm. Një qasje e tillë aplikohet sidomos tek konsumatorët të cilët vendosin të investojnë në ndërtimin e shtëpisë së tyre,

gjë për të cilën këshilltarët për klientë të bankës ProCredit janë mirë të trajnuar për të dhënë këshilla dhe udhëzime të nevojshme. Ndërtimi i shtëpisë komfort qasjes miqësore ndaj ambientit, jo vetëm që do të ndikojë në ruajtjen e ambientit, mirëpo edhe do t'i mundësojë konsumatorit të ulë shpenzimet mujore në të ardhmen, si rezultat i ndërtimit me material të duhur dhe instalimit të pajisjeve efikase në shtëpi.

Për fund, fakti që industria bankare në Kosovë është shumë mirë e zhvilluar, ofron shërbime të ndryshme financiare bashkëkohore për të gjithë, dhe më kryesorja që shërbimi bankar është i qashtë për të gjithë, tregon për rolin që kjo industri ka në ngritjen e vetëdijes rreth investimeve të klientëve. Në këtë kontekst Banka ProCredit luan një rol në shmangien e kredive konsumuese, si element kyç për mbingarkimin e konsumatorit me borxhe të papërbalueshme të cilat në asnjë moment nuk ngrisin kualitetin e jetës. Për dallim, bankat duhet të ofrojnë këshillim financiar, në mënyrë që klientët të mund të investojnë në ngritjen e kualitetit të jetës në familjet e tyre, duke marrë vendime në blerje apo konstruksion shtëpish. Kësisoj, Banka ProCredit ofron këshillim dhe udhëzim gjatë vendimmarrjes së klientëve për investime me kredi hipotekare, ofron këshillim për investime më një qasje miqësore me ambientin, investime efikase në ruajtjen e buxhetit familjar si dhe aplikon qasje etike në shpjegimin transparent të shërbimeve të thjeshta bankare, para se të ofrojë financimin e këtyre investimeve.



# Politikat mbi menaxhimin e riskut nga produktet dhe shërbimet e reja

## Qëllimet themelore të Politikës

Qëllimi thelbësor i politikës është që të elaboroj politikat e analizës së riskut potencial dhe proceset që duhet ndjekur për të menaxhuar me kujdes riskun që lidhet me produktet reja apo të modifikuara dhe shërbime të reja apo të zgjeruara bankare.

Në mënyrë të veçantë, politika përshkruan apetitet e riskut potencial të pajtueshmërisë, për qeverisjen dhe menaxhimin që menaxhmenti i Bankës ndërmerr për të zbatuar një proces efektiv të menaxhimit të riskut, mandej procesin e aprovimit, monitorimit, evoluimit etj.

Parimet e menaxhimit të riskut të përshkruara në këtë politikë zbatohen për futjen e produkteve tradicionale dhe jo-tradicionale dhe shërbimeve bankare, si dhe modifikimet e produkteve dhe shërbimeve ekzistuese. Modifikimet përfshijnë ndryshimet në termat apo natyrën e një produkti apo shërbimi ekzistues që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme karakteristikat themelore të riskut të produktit apo shërbimit (p.sh.: ndryshime të rëndësishme në standardet e përshkruara në marrëveshje, karakteristikat e produktit apo proceseve).

## Risku i mos egzistimit të Politikës

Duke e pasur parasysh faktin që ofrimi dhe lansimi i produkteve të reja apo i zgjerimit të shërbimit bart me vete edhe risk potencial dhe për më shumë praktikant kanë treguar që në qoftë se banka është e fokusuar tepër në kthimet e pritura, por nuk kanë një kuptim të mirë të riskut të trashëguar nga produktet ose kanë praktika të dobëta të menaxhimit të riskut për të matur në mënyrë efektive, monitoruar, dhe kontrolluar riskun potencial në produktet



**NASER KRASNIQI**

MENAXHER I  
PAJTUESHMËRISË

BANKA PËR  
BIZNES (BPB)

ose shërbimet e tilla potencialisht mund të rrezikohen, potencialisht edhe dështojnë.

Ka evidenca nga praktika bankare që bankat shpeshherë nuk i kanë kryer apo bërë analizat e nevojshme paraprake (up-front) për të përcaktuar nëse një produkt i ri apo i modifikuar apo shërbim i zgjeruar ofron profilin e duhur apo risk-kundrejt-kthimit/fitimit dhe nëse është në pajtueshmëri me drejtimin strategjik të bankës. Përveç kësaj, ka po ashtu evidencë që disa banka kanë dështuar të zbatojë kontrolle të përshtatshme të menaxhimit të riskut dhe proceseve. Në disa raste, këto dështime të mbikëqyrjes kanë rezultuar me gabime të kushtueshme, ekspozim të pajustificuar të riskut, dhe shmangie nga plani i biznesit të bankës. Mandej disa banka edhe pse historikisht mirë të menaxhuara kanë gjetur veten të përballur me probleme për shkak të nënvlerësimit të menaxhimit të bankës konform nevojave të saja për të analizuar, monitoruar, dhe të kontrollojë zhvillimin dhe plasimin e një produkti të ri apo zgjerim të shërbimit. Në vend të rritjes së të ardhurave neto, lansimi i produktit të ri apo të modifikuar ose shërbim të zgjeruar ka shkaktuar fyte të

ngushta në procese dhe dështim të kontrollit, duke rezultuar në humbje të kredibilitetit, rritjen e çështjeve të mos - pajtueshmërisë, ekspozimeve gjyqësore, kthimin e pafavorshëm dhe dëmtimin e reputacioni në treg.

### **Qëllimi i përgjithshëm i pajtueshmërisë mbi produktet e reja**

Ne jemi të angazhuar për të siguruar vetëm produkte dhe shërbime që krijojnë vlera për klientët dhe aksionarët përmes plotësimin të nevojave të klientëve. Proceset tona te aprovimit të Produkteve të reja, të modifikuara ose shërbimeve të zgjeruara sigurojnë shqyrtimin e nevojshëm për të arritur këto qëllime dhe për të siguruar që ne me besim mund t'ju ofrojmë klientëve produktet dhe shërbimet tona.

---

**Proceset për produktet e reja, të modifikuara ose shërbimeve të zgjeruara zbatohen për të gjitha ofertat e produkteve të reja, duke përfshirë edhe variacione të produkteve ekzistuese. Të gjitha zhvillimet e produktit duhet të miratohen nga funksionet e kyçe të kontrollit, duke përfshirë Pajtueshmërinë. Komitetet për Produktet e reja të modifikuara ose shërbimeve të zgjeruara duhet të miratohen në nivel të zyrës qendrore, duke përfshirë edhe faktorët e ri të riskut apo të bizneseve.**

---

Proceset për produktet e reja, të modifikuara ose shërbimeve të zgjeruara zbatohen për të gjitha ofertat e produkteve të reja, duke përfshirë edhe variacione të produkteve ekzistuese. Të gjitha zhvillimet e produktit duhet të miratohen nga

funksionet e kyçe të kontrollit, duke përfshirë Pajtueshmërinë. Komitetet për Produktet e reja të modifikuara ose shërbimeve të zgjeruara duhet të miratohen në nivel të zyrës qendrore, duke përfshirë edhe faktorët e ri të riskut apo të bizneseve.

Përveç kësaj, çdo karakteristikë që shkakton shqetësim, të tilla si ndikimi potencial në reputacionin e bankës, duhet të trajtohen në komisionet përkatëse të miratimit të menaxhimit, të tilla si këshilli menaxhues apo komiteti i riskut në nivel Bordit Drejtues për trajtimin e riskut të reputacionit.

### **Procesi i Menaxhimit të Riskut**

Menaxhmenti ekzekutiv i bankës dhe bordi pret për të mbikëqyrur të gjitha produktet e reja, ose modifikuara dhe shërbimet e reja ose të zgjeruara përmes një procesi efektiv të menaxhimit të riskut.

Dështimi për të siguruar një proces efektiv të menaxhimit të riskut është një praktikë jo e mirë bankare dhe e pasigurtë.

Një proces efektiv i menaxhimit të riskut përfshin:

1. ndërmarrjen paraprake të kujdesit adekuat para se të plasohet një produkt i ri në treg,
2. zhvillimin dhe zbatimin e kontroleve dhe proceseve për të siguruar që risku është analizuar, monitoruar dhe kontrolluar siç duhet, dhe
3. zhvillimin dhe zbatimin e monitorimit të duhur të performancës dhe sistemet e shqyrtimit.

Modaliteti i procesit të menaxhimit të riskut në bankë duhet të reflektoj madhësinë dhe ndikimin e produktit të ri, të zgjeruar, ose modifikuar dhe shërbimeve të reja dhe kompleksitetit të produktit apo shërbimit të ofruar. Në varësi të këtyre faktorëve, ajo mund të jetë e përshtatshme për bankën të ngrejë një komitet nën ombrellën e menaxhmentit ekzekutiv apo ta delegoj tek Menaxheri i Pajtueshmërisë për të mbikëqyrur zhvillimin dhe zbatimin e produkteve dhe shërbimeve bankare.



## Vrojtimi/Kujdesi i fokusuar

Para se të vendoset për të plasuar një produkt të ri, të zgjeruar, apo të modifikuar ose zgjerimin e shërbimit ekzistues apo shërbimit të ri për klientë të bankës, menaxhmenti dhe posaçërisht Divizioni i Riskut duhet të bëjë kujdes për të siguruar që ata kanë një kuptim realist të riskut potencial dhe përfitimeve të produktit ose shërbimit që shqyrtohet. Menaxhmenti dhe Divizioni i Biznesit me Klient duhet të kuptojnë qartë arsyen për të ofruar produktin apo shërbimin.

Procesi vrojtimit/kujdesit të fokusuar duhet të përfshijë:

- Vlerësimin se si risku që lidhet me produktin e ri, të zgjeruar, apo modifikuar apo shërbimin përshtatet me strategjinë e biznesit të bankës dhe të profilit të riskut.
- konsultimin me fushat përkatëse funksionale, të tilla si kredi, pajtueshmëri, kontabilitetit, auditimit, menaxhimi i riskut, ligjore, operacionale, teknologjinë e informacionit dhe marketingut, si dhe Komitetin e ALCO-së për të përcaktuar riskun, shqetësimet, dhe kontrollet e nevojshme.
- Përcaktimin e kërkesave për përputhje me ligjet, rregulloret, dhe udhëzimet rregullatorëve relevant.
- Përcaktimin e ekspertizës së nevojshme për të menaxhuar në mënyrë efektive produktet ose shërbimet, duke përfshirë edhe nevojën e mundshme për të marrë ekspertizë shtesë.
- Hulumtimin e përmbajtjes së produktit/shërbimit, përvoja, dhe besueshmëria e palëve të treta përkatëse.
- Zhvillimin e një plani të biznesit dhe plani financiar për produkt ose shërbim që vlerëson pozicionin konkurrues të bankës dhe përcakton objektivat dhe strategjitë për mënyrën se si produkti ose shërbimi do të sjellë në treg.
- Hulumtimin mbi koston e produktit të ri apo të modifikuar ose shërbimit të ri apo të zgjeruar.
- Zhvillimin alternativ, duke përfshirë një strategji dalëse/anulimi apo ndërprerje në rast se produkti ose shërbimi dështon për të arritur pritshmërinë.

Edhe pse Divizioni i Riskut mund t'ia delegojë kryerjen e detyrave mbi analizat dhe vlerësimin e riskut tek të tjerët, megjithatë ai ka përgjegjësinë e fundit për të siguruar që banka është e drejtuar në një mënyrë të sigurtë dhe të shëndoshë. Në përmbushjen e përgjegjësisë të tij, Divizioni i riskut apo i deleguari i tij duhet të sigurojë që një produkt i ri apo i modifikuar ose shërbimi i ri apo i zgjeruar bankar është në konsistencë me qëllimet strategjike të Bank-së.

## Menaxhimi i riskut dhe kontrolli i proceseve

Pasi banka vendos për të plasuar një produkt të ri apo të modifikuar ose shërbim të ri apo të zgjeruar dhe zhvillon një plan biznesi, Menaxhmenti, Divizioni i Riskut, Sektori i Pajtueshmërisë duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë proceset e duhura të menaxhimit të riskut për të kontrolluar në mënyrë efektive riskun e veprimtarisë.

Kjo duhet të përfshijë:

- Zgjerimin dhe ndryshimin e politikave dhe procedurat e bankës, sipas nevojës, për të siguruar që Divizioni i Biznesit me Klient në mënyrë adekuate do ta adresoj produktin apo shërbim në treg, politikat dhe procedurat duhet të freskohen dhe të përshkruajnë llogaridhënien dhe të sigurojnë fushë të veçantë për monitorimin e përjashtimeve.
- Zhvillimin dhe implementimin e sistemit të raportimit të informacionit (MIS) të nevojshme për të monitoruar respektimin me objektivat e vendosura dhe për të mbikëqyrur siç duhet produktin apo shërbimin e ri, të zgjeruar apo modifikuar.
- Raporti nga MIS duhet të përmbajë treguesit kryesorë për ti mundësuar kontrollit të brendshëm që të identifikoj në mënyrë efektive devijimet, procesin e monitorimit, ndërmarrjen e masave dhe riskun e kontrollit.
- Përfshirja e produktit të ri apo te modifikuar ose shërbimit ri apo te zgjeruar në procesin e brendshëm të auditimit dhe të pajtueshmërisë për të siguruar adekuatshmërinë dhe implementimin me politikat dhe procedurat e bankës dhe masat mbrojtëse të konsumatorëve.

### Monitorimin i performancës së produktit apo shërbimit të ri

Divizioni i Riskut duhet të ketë sisteme të përshtatshme të vendosura të vlerësimit të performancës dhe të monitorimit për ti mundësuar Menaxhmentit në vendimmarrje dhe për të vlerësuar nëse produkti ose shërbimi ka arritur pritjet operationale dhe strategjike.

Sistemet e tilla duhet të:

- Përfshijë kufizime në madhësinë e ekspozimit të riskut të pranueshëm se menaxhmenti dhe bordi janë të gatshëm për të marrë përsipër.
- Identifikimi i objektivave specifike dhe kriteret e performancës për të vlerësuar suksesin e produktit apo shërbimit.
- Kriteret e performancës duhet të përfshijnë standardet kualitative dhe kuantitative që do të shërbejnë si një mjet për të vlerësuar suksesin e produktit apo shërbimit.
- Reflektin një proces që periodikisht krahason rezultatet aktuale me parashikimet dhe standardet cilësore, për të zbuluar dhe adresuar trendet negative apo shqetësime në kohën e duhur.
- Ndryshimet esenciale në planin e biznesit, kur është e përshtatshme duke u bazuar në performancën e produktit apo shërbimit. Ndryshime të tilla duhet të përfshijnë daljen/anulimin apo ndërprerjen e produktit apo shërbimit kur rezultatet aktuale të dështojnë për të arritur parashikimet apo pritshmërinë.

### Menaxhimi i riskut të palëve të treta

Risku unik është përfshirë kur një bankë merr një produkt të ri, të modifikuar apo shërbime të reja apo të zgjeruara përmes ofruesve të shërbimeve apo palës së tretë. Performanca inferiore apo shërbimi nga ana e një ofruesi shërbimesh mund të rezultojë në riskun potencial të paparashikuar, duke përfshirë kosto ose humbje të biznesit në bankë dhe me konsekuenca ligjore.

Edhe pse shumica e ofruesve të shërbimeve janë të respektuar, produktet e tyre mund të jenë të pa-provuara, ose risku potencial që lidhen me produktin apo shërbimin mund të bien ndesh me sigurinë dhe standardet apo masat mbrojtëse të kontrollit të brendshëm ose kërkesave të pajtueshmërisë.

Produktet apo shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve nuk mund të jenë të përshtatshme për tregun unik, personelin, apo mjedisin biznesor ku afaron Banka. Ky risk mund të keqësohet nga të ashtuquajturat “çështje-kyç”, marrëveshjet që janë projektuar për të siguruar bankën vetëm me përfshirje minimale në administrimin dhe mbikëqyrjen e produktit apo shërbimit të ofruar nga pala e tretë.

Divizioni i Riskut duhet të sigurojë që e kupton riskun që lidhet me aktivitetin dhe vlerësimin e kujdesit adekuat dhe të duhur të ofruesit të shërbimeve, duke përfshirë edhe riskun e reputacionit, produktet, dhe gjendjen financiare. Divizioni i riskut gjithashtu duhet të zbatojë një program të vazhdueshëm të mbikëqyrjes mbi aktivitetet e ofruesit të shërbimit dhe të zhvillojë një plan emergjent në rast se ofruesi i shërbimit nuk mund ti përmbush shërbimet e pritura. Divizioni i Riskut nuk duhet të mbështetet shumë në pohimet e ofruesit të shërbimeve ose rekomandimeve por duhet të bëjë analizën e vet për tu siguruar që ofruesi i shërbimeve dhe produktet e tij janë një përshtatje e mirë për bankën.

### Risku i ndërlidhur

Planifikimi, mbikëqyrja, dhe kontrolli i dobët mund të shpijë në një vlerësim jo të plotë dhe të kuptuarit e riskut të përfshirë me produkte të reja, të modifikuara ose shërbimeve të zgjeruara bankare. Ky seksion thekson riskun primar që lindin gjatë fazës së zhvillimit dhe lansimit.

### Risku Strategjik

Risku me fitimin ose kapitalin që rrjedh nga vendimet e pafavorshme administrative apo zbatimin jo të drejtë të këtyre vendimeve.

Risku Strategjik lind kur Banka afaron me produkte dhe shërbime të cilat nuk janë në pajtueshmëri me qëllimet strategjike të Bankës ose që nuk ofrojnë një kthim të duhur të investimeve. Ky lloj i riskut rritet kur lansohet një produkt i ri apo i modifikuar ose shërbim i ri apo i zgjeruar pa kryer studimet paraprake të duhura të vrojtimit/kujdesit të fokusuar ose pa zbatimin e një infrastrukture të përshtatshme të menaxhimit të riskut për të mbikëqyrur veprimtarinë.

Risku Strategjik gjithashtu rritet kur masat vlerësuese dhe mbrojtëse të kontrollit të brendshëm (risku kreditor, risku i tregut, risku operacional, kontrolli financiar dhe risku i pajtueshmërisë) nuk e kanë ekspertizën dhe përvojën adekuate për të mbikëqyrur siç duhet produktet ose shërbimet e ofruara.

### **Risku i Reputacionit**

Risku me fitimin ose kapitalin që rrjedh nga opiniononi negativ i publikut. Risku i Reputacionit ndodh kur banka lanson një produkt të ri, të modifikuar ose shërbimit të zgjeruar pa i kuptuar plotësisht objektivat e klientëve të tij të biznesit ose qëllimet ekonomike të transaksionit.

Risku i reputacionit gjithashtu lind kur banka fokusohet për fitimet duke ofruar produkte apo shërbime që përfshijnë praktika apo teknika që dallojnë nga standardet e bankës respektivisht aplikon praktika agresive.

Duke kontraktuar palët e treta të reja që të ofrojnë produkte ose shërbime, ose zgjerimin e shfrytëzimit të shërbimit të palëve ekzistuese të treta, Banka mund të ekspozohet ndaj riskut të reputacionit. Ky risk rritet kur funksioni i pajtueshmërisë nuk arrin të siguroj dhe monitorojë nga afër cilësinë dhe

---

**Risku i reputacionit rritet me shërbime të dobëta, rekomandimin dhe ofrimin e produkteve të papërshtatshme, apo shkeljen të ligjit të konsumatorit, masat jo adekuate mbi mbrojtjen e të dhënave personale, masat jo adekuate apo shkeljet e konfidencialitetit biznesor ku secila mund të rezultoj në çështje gjyqësore, marketing negativ dhe humbjet biznesore drejt dëmtimit të reputacionit dhe imazhit të bankës.**

---

përshtatshmërinë e produkteve apo shërbimeve të ofruara, posaçërisht në rastet kur punonjësit e palës së tretë ndërveprojnë direkt me klientët e bankës, atëherë rrit riskun e reputacionit nëse ndërveprimet janë në kundërshtim me politikat, praktikatat dhe standardet e Bankës.

### **Risku i Transaksionit**

Banka është e ekspozuar ndaj riskut të transaksionit kur produktet apo shërbimet, apo edhe kanalet e ofrimit të shërbimeve nuk përshtaten me kapacitetet ekzistuese operationale, kërkesave të konsumatorëve, apo objektivave strategjike të bankës.

Risku i transaksionit mund të rritet me instalimin e teknologjisë së re të informacionit për të mbështetur një produkt të ri, të modifikuar apo shërbim të ri apo të zgjeruar. Dështimi apo teknologjia informatike me të meta ose nga gabimet humane, mandej, kapacitetet e pamjaftueshme ose mashtrimi mund të rezultojë në pamundësinë për të ofruar produkte apo shërbime.

### **Risku i Pajtueshmërisë**

Risku me fitimin apo kapitalin që rrjedhin nga shkeljet e ligjeve, rregulloreve të autoriteteve mbikëqyrëse, ose nga mos-pajtueshmëria me politikat dhe procedurat e brendshme ose standardet e etikës biznesore - kodit të mirësjelljes.

Risku i Pajtueshmërisë lind kur një produkt i ri apo i modifikuar ose shërbim bankar i ri apo i zgjeruar nuk është i monitoruar siç duhet nga këndvështrimi i pajtueshmërisë me ligjin, standardet etike, apo politikat dhe procedurat e bankës. Potenciali për shkelje të rënda ose të shpeshta të mos pajtueshmërisë rrjedh kur programi i pajtueshmërisë dhe kontrollit të brendshëm nuk është i përfshirë në planin e auditimit.

Risku i Pajtueshmërisë rritet kur privatësia e të dhënave të konsumatorëve nuk është e mbrojtur, kur konfliktet e interesit në mes të bankës respektivisht punëtorëve të bankës dhe palëve të treta të lidhura nuk menaxhohen si duhet dhe kur banka ose ofruesit e shërbimit nuk kanë zbatuar programe të përshtatshme të sigurisë së informacionit. Risku i Pajtueshmërisë rritet gjithashtu nga praktikatat e papërshtatshme të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

# Fjala e anëtarit të ri të Bordit të SHBK-së dhe Kryeshefit të ri Ekzekutiv të BpB-së

## Të nderuar lexues,

Më lejoni që të ju përshëndes nga pozita ime e re si Kryeshef Ekzekutiv në BPB dhe në të njëjtën kohë si anëtar i ri i bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës.

Dëshiroj të ndaj këndvështrimin tim rreth zhvillimeve momentale në sektorin bankar në Kosovë dhe pritshmëritë për përcjelljen e zhvillimeve dhe trendeve në përgjithësi.

Vlenë të theksohet se sektori financiar në vendin tonë në mënyrë të vazhdueshme ka treguar një qendrueshmeri stabile përgjate gjithë periudhave kohore e që ka rezultuar të jetë një bazë solide e zhvillimeve ekonomike në vend. Këtë qëndrueshmëri e ka stimuluar edhe një bashkëpunim efikas në mes të institucioneve financiare dhe BQK-së si rregullatore të këtij sektori, duke e bërë sektorin financiar shembull edhe për shumë vende tjera. Indikatorët makroekonomik, me përjashtime të vogla në disa periudha kohore po ashtu kanë qenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe kanë perkrahur përmirësimin e ambientit të bërit biznes, që është indikator i padiskutueshëm për avansimin e ekonomisë në përgjithësi.

Gjatë viteve të fundit, vërehet një fokusim i theksuar i sektorit bankar drejt efikasitetit operacionale për t'i bërë shërbimet bankare më të lehta për shfrytëzuesit. Ky ripozicionim është rrjedhojë edhe bizneseve, por edhe riorganizative për simplifikimin e aktiviteteve që nuk janë thelbësore për natyrën e biznesit bankar. Kjo qasje është vërtetuar si e suksesshme edhe në tregjet europiane dhe ato globale, kështu që besojmë se edhe në tregun tonë do të rezultojnë të jenë rruga e vetme për t'i sjellur produktet bankare më afër klienteve. Ndryshimet dhe më pas sfidat në industrinë bankare janë të pa ndalshme, njëra nga më të fundit është ajo e rënies së interesave në treg, e cila ka shtyrë sektorin drejt efikasitetit më të lartë, por edhe ka paraqitur një mundësi për klientelën në ngritjen e kërkesës për kredi dhe në stimulimin e transakcioneve të përgjithshme bankare. Ngritja e portfolios kreditore në kushtet e rënies së normave të interesit është kusht për bankat që të arrijnë performancë të kënaqshme financiare. Prandaj, në mënyrë të drejtëpërdrejtë pritjet që kjo të ketë edhe ndikimin e vet në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Në aspektin e fushës së investimeve në vendin tonë, mundësi e mire mund të konsiderohet edhe investimi në letrat më vlerë, që është e mundur të bëhet edhe për klientët tonë të nderuar.

## ARTON CELINA

KRYESHEF EKZEKUTIV,  
BANKA PËR BIZNES



Siç edhe jeni të informuar, nga tregu i sektorit financiar, progresi në përmirësimin e legjislacionit e sidomos kur flasim për aspektin e përmbartësve privat ka ndihmuar përditësimin në avancimin e mëtejshëm të pjesës së kontesteve juridike, pjesë kjo e cila ka ndikuar në mënyrë të theksuar në politika kreditore të bankave në Kosovë. Avansimi i metutjeshëm i këtij procesi me siguri se do të jetë shtytës i madh i ngritjes së ofertës kreditore në tregun bankar të Kosovës. Në gjithë këto diskutimet mbi sfidat e sistemit dhe nevojës për një operacionalizim efikas të biznesit bankar, mendoj që nuk mundemi pa theksuar nevojën për digjitalizim të shërbimeve bankare dhe solucioneve inovative që revolucioni teknologjik na bën të mundur. Po ashtu sikurse e mbarë bota edhe tregu financiar në Kosovë i është ekspozuar thellësisht inovacionit dhe sa më shumë që bankat i orjentojnë resurset e tyre në këtë drejtim, mendoj që suksesi do të jetë më i theksuar.

Për të përmblytur këndvështrimin personal në këtë përmbledhje, dua të theksoj se industria në të cilën veprojmë është duke kaluar nëpër fazë të eksperimenteve dhe inovacioneve të shpejta dhe këto ndryshime mund t'i trajtojmë si mundësi biznesi në çdo kohë. Ndërrimi gradual i demografisë së klientëve dhe parapëlqimeve të tyre paraqet kërkesë të re për industrinë, për të lëvizur gradualisht nga mënyra tradicionale dhe këshilluese, në një model për shërbime më të mira dhe më të shpejta. E gjithë kjo varet shumë nga qasja jonë për tu përballur me mundësitë për të përfutur strukturë të re të klientëve dhe njëkohësisht duke zvogëluar riskun e mbajtjes së klientëve ekzistues pavarësisht konkurrencës dhe interferencës digjitale. Ne, në Bankën për Biznes jemi të perkushtuar të jemi pjesë aktive e këtij sektori dhe të punojmë me vendosmëri për tu ballafaquar me të gjitha sfidat që i sjell tregu sepse besojmë që klientët tonë duhet të kenë qasje të pakufizueshme në inovacionet dhe teknologjitë e avancuara bankare.


# Ndryshimet në kartëmonedha të paraqitura nga Banka Qendrore Evropiane

Kartëmonedhat e reja janë prezantuar nga Banka Qendrore Evropiane përgjatë disa viteve. Kështu, kartëmonedha e re prej € 5 është fut në qarkullim në vitin 2013, kartëmonedha e re prej € 10 është fut në qarkullim në vitin 2014 si dhe kartëmonedha e re prej € 20 është fut në qarkullim në vitin 2015.

Më 5 korrik 2016 Banka Qendrore Evropiane në Frankfurt, Gjermani prezantoi kartëmonedhen

e re në vlerë prej €50. Kjo është kartëmonedha e katërt e serisë së Europes dhe pason bankënotat prej €5, €10 dhe €20 që tashmë janë vënë në qarkullim. Është planifikuar që kartëmonedha e re në vlerë prej €50 të fillojë të qarkullojë në pranverë të vitit 2017.

**Më poshtë mund të gjeni si duken kartëmonedhat e reja €5, €10, €20 dhe €50:**



# Cili është dallimi në mes të normes nominale dhe reale të interesit?

Norma e interesit është kostoja e kredisë ose kthimi nga kursimet. Nëse një person huazon nga një bankë, atëherë norma e interesit është ajo që ata paguajnë për kredisë të tyre. Në rast të kursimeve në një bankë, interesi është kthimi që personi merr në kursimet e tyre. Ekonomistët bëjnë dallimin midis normes "nominale" dhe "reale" të interesit, por çfarë është dallimi në mes të dyjave dhe pse është i rëndësishëm? Norma nominale e interesit është norma që është rënë dakord dhe është paguar. Për shembull, është norma që pronarët e shtëpive paguajnë në hipotekën e tyre ose kthimi që kursimtarët marrin në depozitat e tyre. Huamarrësit paguajnë normën nominale dhe kursimtarët e marrin atë.

Megjithatë, nuk është vetëm pagesa nominale që është e rëndësishme për huamarrësit dhe kursimtarët, por edhe sasia e mallrave, shërbimeve ose gjërave të tjera që ata mund të blejnë me paratë. Ekonomistët e quajnë

këtë fuqi blerëse e parave, e cila zakonisht zvogëlohet me kalimin e kohës me rritjen e çmimeve për shkak të inflacionit. Zbritja e kësaj humbjeje të fuqisë blerëse nga norma nominale e interesit mundëson huamarrësit dhe kursimtarët të përcaktojnë normën reale të interesit në kreditë dhe kursimet e tyre.

## Shembull

Një kursimtarë që deponon 1,000 Euro në një llogari për një vit mund të ketë një normë nominale interesi prej 2.5%, dhe kështu të merr 1,025 Euro në një vit. Megjithatë, nëse çmimet rriten për 3%, ai ose ajo do të ketë nevojë për 1,030 Euro për të blerë të njëjtat mallra ose shërbime që një vit më parë, do të kushtonin 1,000 Euro. Kjo do të thotë se kthimi real në të vërtetë do të kishte qenë -0.5%. Kjo është norma reale e interesit dhe llogaritet duke zbritur normën e inflacionit (3%) nga norma nominale e interesit (2.5%).

## Normat nominale dhe reale të interesit në depozitat bankare afatshkurtra në vendet e eurozonës (Përqindjet)



Burimi: Eurostat, BQE, NCBs, vlerësimet e BQE

Burimi i artikullit: [https://www.ecb.europa.eu/explainers/tell-me/html/nominal\\_and\\_real\\_interest\\_rates.en.html](https://www.ecb.europa.eu/explainers/tell-me/html/nominal_and_real_interest_rates.en.html)

# Karakteristikat kryesore të kartelave të kreditit

Kartela e kreditit ofron shumë përfitime për përdoruesin. Mirëpo, janë disa karakteristika që mund t'ju ndihmojnë ta përdorni kartelën e kreditit në mënyrë edhe më ekonomike.

## Periudha e mospagimit

Periudha e mospagimit do të thotë që për këtë numër të ditëve, juve nuk ju ngarkohet norma e interesit në shumën që e shpenzoni. Megjithatë, periudha e mospagimit do të thotë periudha maksimale pa ngarkesa. Periudha maksimale e mospagimit nuk vlen për secilin transaksion, por ka data fikse. Do të thotë, numri i ditëve pa normë të interesit varet nga data kur e keni bërë blerjen. Ta shohim shembullin.

Periudha kontabël me data: një periudhë mujore, në fund të së cilës transaksionet përmblihen;

Periudha maksimale e mospagimit me data: periudha maksimale, pas së cilës ju duhet të filloni t'i paguani paratë e shpenzuara;


Shembull i datës së blerjes: supozoni që në këtë datë e keni blerë një frigorifer duke përdorur kartelë të kreditit;

Data e pagesës: fundi i periudhës suaj të mospagimit, kur ju duhet të filloni të paguani;

Koha e mbetur deri në fund të periudhës kontabël: koha që fillon të numërohet nga data e blerjes suaj deri në datën e pagesës.

Koha e mbetur deri në fund të periudhës së mospagimit: koha ndërmjet datës së blerjes dhe fundit të periudhës kontabël, plus pjesa e dytë konstante e periudhës së mospagimit.

Periudha reale e mospagimit: koha ndërmjet datës së blerjes suaj dhe ditës kur duhet të filloni të paguani paratë e shpenzuara. Në fund, fleta juaj fillimisht e zbrazët duhet të duket kështu:



Periudha e mospagimit nuk është konstante - kohëzgjatja e saj varet nga data e blerjes - sa më afër fundit të muajit, aq më e shkurtër është periudha e pagesës.

### Shuma minimale e pagesës

Pra tash e dimë se sa mund të rrimë pa paguar - e dimë saktësisht periudhën e mospagimit. Por do të vijë një ditë kur duhet të fillojmë të paguajmë. Të fokusohemi tash në ditën e pagesës: sa mund të paguani në këtë datë? Në datën e pagesës, mund ta paguajmë tërë shumën, që është 100% e shumës që e kemi shpenzuar brenda periudhës së pagesës, ose mund ta paguajmë shumën minimale, që është vendosur më herët në marrëveshje me bankën. Mund të jetë 10%, 15% e parave të shpenzuara në periudhën e dhënë kontabël.

Pra e paguajmë ose shumën totale, ose pjesën e vendosur me marrëveshje, për shembull 10% të shumës së parave të shpenzuara në periudhën e dhënë kontabël.

Këtu është me rëndësi të kuptohet ndryshimi:

- Nëse paguajmë 100% të shumës që e kemi shpenzuar, nuk paguajmë asnjë ngarkesë.
- Nëse paguajmë vetëm 10%, atëherë ngarkohemi me normën e interesit për 90% të mbetura.

Mbani mend që është më mirë të paguhet e tërë shuma para fundit të periudhës së mospagimit, që të mos ngarkohet fare normë e interesit.

### Tërheqja e parave

Shumë klientë përdorin kartelat e kreditit për tërheqje të parave. Mirëpo këto transaksione kanë ngarkesa për çdo tërheqje. Për shembull

për kartelën tuaj të kreditit ju ngarkoheni me 1% të shumës që e tërhiqni, ose në minimum 1 euro. Nëse tërhiqni para nga bankomatët e bankave të tjera, këto ngarkesa janë më të larta. Gjithsesi, konsultohuni me bankën tuaj cila është ngarkesa në rast të tërheqjes së parave.

### Ngarkesat tjera

Është edhe një rregull që duhet të respektohet nëse dëshironi të ulni kostot e përdorimit të kartelës së kreditit. Kur paguani me kartelë të kreditit në një shitore, restorant ose vend tjetër që pranon pagesa me kartelë të kreditit, sigurohuni që makina e POS-it të jetë e lidhur me bankën tuaj. Nëse makina e POS-it i takon bankës suaj, transaksioni është falas. Nëse i takon një banke tjetër, ju ngarkoheni me një shumë të caktuar.

### Limitet e kartelave

Kartela juaj e kreditit ka disa limite: në aktivitetet ditore me para të gatshme dhe në bilancin mujor. Është më mirë të qëndroni brenda limiteve.

### Si përfundim, dëshirojmë t'juaj përkujtojmë pikat në vijim:

- Me secilën ditë të muajit që kalon, periudha e mospagimit sa vjen e shkurtrohet.
- Nëse paguani vetëm një pjesë të bilancit të kartelës së kreditit, mbani mend që ngarkoheni me pjesën tjetër në bilancin e mbetur.
- Mos u vononi me pagesat në mënyrë që të evitoni ngarkesat shtesë.
- Kufizoni tërheqjet në para të gatshme nga bankomatët për t'i evituar ngarkesat shtesë.





# Karakteristikat e E-banking

E-banking ka disa përparësi për klientin dhe është komod të përdoret.

- ✓ Përfitimi kryesor është që kurseni kohë - në vend se të kaloni kohën në degë, duke pritur punonjësit që të ju shërbejnë, ju i kaloni 10 minuta në kompjuter dhe mund ta dedikoni pjesën tjetër të kohës familjes / aktiviteteve të lira / shoqërisë, etj.
- ✓ Mund t'i paguani shpejt shërbimet komunale, ose të u dërgoni para familjarëve, pa pasur nevojë të shkoni te ata ose të shkoni në bankë.
- ✓ Ju keni vazhdimisht qasje në llogarinë tuaj - mund ta kontrolloni gjendjen, dhe të gjitha transaksionet e kryera, kudo dhe në çdo kohë të ditës - vetëm ju duhet interneti.

Megjithatë, dëshirojmë të i analizojmë të kundërtat e përparësive. Të gjitha bankat kërkohet të sigurojnë sigurinë e parave të klientëve. Ato mbajnë sisteme të sigurisë në internet. Për të kontrolluar nëse është i siguar sistemi, së pari duhet të siguroni dy gjëra:

- Që adresa e faqes në internet fillon me <https://>, jo me <http://> - 's' duhet të jetë aty, sepse kjo tregon se të dhënat që i dërgoni janë të fshehta dhe nuk mund të 'shihen' nga të tjerët.
- Është edhe simboli i dryrit, që gjithashtu vërteton sigurinë e sistemit.



Edhe pse bankat bëjnë gjithçka për të siguruar qasjen në llogarinë tuaj, ka pak përgjegjësi edhe nga ana juaj - duhet të siguroni kushtet, që do të ndihmojnë që të funksionojë siguria e sistemit.

Duhet të ndiqen katër rregulla të thjeshta për të siguruar që siguria e sistemit funksionon si duhet.

1. Përdorni kompjuterin tuaj të siguar me program anti-virus të instaluar. Evitoni përdorimin e kompjuterëve në Internet kafe, në aeroporte, hotele dhe vende publike, përveç bankës suaj.
2. Përdorni një fjalëkalim unik për sistemin tuaj. Nuk duhet të lidhet me emrin tuaj, adresën, ditëlindjen. Ndërroni rregullisht fjalëkalimin.
3. Ruajeni fjalëkalimin tuaj. Nëse duhet ta shkruani që ta mbani mend, shkruajeni ashtu që vetëm ju të mund ta njihni se ky është emri i kyçjes dhe fjalëkalimi. Mos ia jepni fjalëkalimin të tjerëve, as familjes ose miqve.
4. Kini kujdes për emaila, në të cilët dikush kërkon nga ju t'i jepni të dhënat personale ose të dhënat e bankës.

## Si përfundim me E-banking:

- Paratë e juaja janë po aq të sigurta sa në degë të rregullt.
- Keni qasje në internet 24 orë në ditë 7 ditë në javë në shërbimet e e-banking.
- Ju jeni përgjegjës për të siguruar sigurinë e llogarisë suaj: kompjuter të sigurt, qasje në internet, fjalëkalime, mospërfshirjen e të tjerëve në aktivitete.

## U mbajt Forumi i Hapur: Sektori bankar dhe sistemi i zbatimit të kontratave në Kosovë



**14 qershor, 2016** –Shoqata e Bankave të Kosovës, sot më 14 qershor organizoi Forumin e Hapur me temë Sektori bankar dhe sistemi i zbatimit të kontratave në Kosovë.

Forumit filloi me fjalimet hapëse nga z. Petrit Balija nga Shoqata e Bankave të Kosovës, përfaqësuesi rezident i zyrës së Fondit Monetar Ndërkombëtar z. Ruud Vermeulen si dhe zëvendës-guvernatori z. Fehmi Mehmeti nga Banka Qendrore e Kosovës.

Forumit në përbërje kishte ekspertë të fushës së legjislacionit dhe sistemit bankar të cilët diskutuan për këtë temë në dy panele.



Paneli i parë përfshinte panelistët: z. Fehmi Mehmeti-zëvendës guvernator, Banka Qendrore e Kosovës, Robert Wright –nënkryetar i bordit të drejtorëve në Shoqatën e Bankave të Kosovës, CEO në Raiffeisen Bank, z. Fadil Hoxha –nënkryetar, Oda e Përmbareshve Privat. Ky panel diskutoi për sistemin e zbatimit të kontratave në Kosovë dhe ndikimi i tij tek Kreditë jo-përforumuese. Paneli u moderua nga z. Mentor Hajdaraj –kryetar i Komitetit Ligjor në Shoqatën e Bankave të Kosovës.



**Paneli i dytë** kishte në përbërje znj. Feride Podvorica nga Departamenti Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, z. Ardi Shita – ekspert i lartë ligjor nga USAID –Programi për Përmbarrim dhe Legjislacion Komercial, z. Gjokë Radi – anëtar i Bordit, Oda e Përmbarruesve

Privat, Isa Shala - gjyqtar, Gjykata e Apelit, dhe z. Ilir Gaxha nënkryetar i Komitetit Ligjor në Shoqaten e Bankave të Kosovës, njëherësh moderator i këtij paneli. Paneli diskutoi mënyrat e përmirësimit të Mjedisit të Rrezikut si dhe Kreditë hipotekare.



## Sistemi bankar në Kosovë, stabil



Sistemi bankar në Kosovë është stabil, i qëndrueshëm dhe pa ndonjë paralajmërim shqetësues. Madje, normat e rritjes janë më të larta se treguesit makroekonomik në vend. Bankat komerciale të vendin kanë dëshmuar edhe ndikim mjaft të madh në rritjen e përgjithshme ekonomike, e cila vjet i është afër 3.6 për qind.

Këto ishin disa nga konstatimet që u thanë gjatë punëtorisë tradicionale dyditore me gazetarët-

raportues për ekonominë në njëzet medime të shkruara dhe elektronike, nën moton “Të bëjmë lajm nga numrat”, të mbajtur të premtën dhe të shtunën në Prevallë, nën organizimin e Qendrës për Hulumtime Strategjike e Sociale –STRAS, i përkrahur edhe nga Shoqata e Bankave të Kosovës dhe Fondi Evropian për Evropën Juglindore – EFSE nga Gjermania.



Gjatë dy ditëve gazetarët kishin mundësi të dëgjojnë paraqitjet dhe të zhvillojnë debat me përfaqësues dhe ekspertë të Bankës Qendrore të Kosovës, Shoqatës së Bankave të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës, bankave komerciale dhe të bizneseve. Ndërkaq, qëllimi parësor ishte ofrimi i të dhënave për rrjedhat në sistemin bankar, reflektimi i reformave qeveritare në qëndrueshmërinë e këtij sistemi, përkrahja e bizneseve jo vetëm për financimin e zhvillimit, pro edhe me shërbime të avancuara, si edhe avancimin e raporteve ndërmjet mediave dhe institucioneve të sistemit bankar, me qëllim të pasqyrimin të pasqyrës reale.

Guvernatori i BQK-së, Bedri Hamza prezantoi situatën aktuale në sistemin bankar, duke përfshirë të arriturat dhe sfidat e tij. "Sistemi bankar në Kosovë ka një rritje të vazhdueshme, likuiditet të lartë dhe stabilitet. Kreditë janë gati 2.1 miliardë euro, depozitat janë mbi 2.6 miliardë euro, ndërsa norma e interesit në kredi është në rënie. Në fund të prillit ka qenë 7.9 për qind. Më askush nuk mund të thotë se Kosova është vendi me norma më të larta në rajon. Jemi rreth mesatares së tij", ka thënë Hamza. "

Më tutje, Ilir Aliu, kryetar i Bordit të SHBK-së bëri një vështrim për tregun bankar dhe zhvillimin konkurrencës brenda tij. "Janë dhjetë banka, të cilat ofrojnë konkurreshmëri të mirë në treg. Pa dyshim s kjo është arritur

edhe me futjen e bankave të reja, me të cilat klientët kanë mundësi më të mëdha për përzgjedhjen e bankës së vet", ka thënë Aliu. Në vazhdim ai ka elaboruar edhe ndikimin bankave në biznese. Sipas tij, kreditë janë në rritje, normat e interesit janë në rënie, njësoj sikurse edhe të hyrat e bankave. Kjo ka mundësuar që bizneseve t'iu mbetet një sasi më e madhe e parave.

Më tutje Gjylfidane Kadriaj, drejtoreshë e Departamentit të Sistemit të Pagesave në BQK foli për qarkullimin e parasë, për vëllimin e transaksioneve dhe të pagesave, si edhe për instrumentet e pagesave që aplikohen në Kosovë.

Eriola Bibolli, zëvendës drejtoreshë në "ProCredit Bank" bëri një analizë për digjitalizimin e sistemit bankar në vend, duke krahasuar me rajonin dhe me disa vende në BE.

" Në shumë shtete është gjithnjë e më i rrallë kontakti fizik ndërmjet bankës dhe klientit. Ai bëhet në mënyrë elektronike. Madje, ka banka, të cilat operojnë vetëm nga një zyrë, por kanë një shtrirje të gjerë, të cilën ia mundëson digjitalizimi i shërbimeve. Këtë rrugë është duke ndjekur edhe Kosova", tha Bibolli.

Në vazhdim, Debatik Hoxha nga kompania "Gjirafa.com" tregoi se duke shfrytëzuar teknologjinë nformative kjo kompani ka arritur



një shtrirje të gjerë. Madje, ajo shumë shpesh do të ketë ofertë të re, si për blerje on-line, apo për informata që janë me interes për qytetarin, si nga lëmi i qarkullimit dhe transportit, po ashtu edhe nga hoteleria e turizmi.

Petrit Balijs, drejtor ekzekutive i SHBK-së, foli për rolin e Shoqatës së Bankave në ndërtimin e sistemit bankar në vend, si edhe për ndikimin saj në koordinimin raporteve ndërmjet bankave komerciale në vend. Sipas tij, përbrenda mekanizmave të kësaj shoqate është e ndaluar që të bisedohet për kostot e shërbimeve të bankave dhe në këtë mënyrë është siguruar që ajo të mos jetë vend i marrëveshjeve të tilla, por

çmimet e shërbimeve të mbeten çështje e brendshme e bankave.

Qemajl Marmullakaj, drejtor i Zyrë për Planifikim Strategjik në ZKM, elaboroj rëndësinë e Fondit për Garantimin e Kredive në forcimin e pozitës si bizneseve, por njëkohësisht ai i ofron siguri më të madhe edhe sistemit banar të vendit. Në fund i punëtorisë Hekuran Murati, nga Departamenti i Thesarit foli për përvojat e deritashme në tregun letrave me vlerë, ndikimin tyre në qëndrueshmërinë e buxhetit, por edhe mundësinë që iu ofrohet bankave për investime.

## Luksemburgu mbështet zhvillimin e sektorit bankar në Kosovë

Shoqata e Bankave të Kosoves është vizituar nga përfaqesuesi i Agjencise për transfer të teknologjisë financiare (ATTF) nga Luksemburg z. Ben Lyon. Drejtori ekzekutiv i Shoqates së Bankave të Kosoves falenderoi z. Lyon si dhe shprehu mirënjohjen e sektorit bankar për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Luksemburgut dhe Ambasaden e Luksemburgut në Kosovë për mbështetjen e tyre dhe partneritetin që po ndërtohet në mes të këtyre institucioneve. Z. Balijs tha që Luksemburgu është një ndër qendrat financiare më të rëndësishme botërore dhe sistemi bankar në Kosovë mund të përfitojë shumë nga ky bashkëpunim. Në këtë takim u diskutua edhe mbi proceset integruese të

Kosoves në arenën ndërkombëtare financiare dhe mundësitë që ATTF ofron për të përgatitur kapacitetet e sektorit bankar për integritet përfshirë këtu edhe adaptimin e standardeve të Basel-it. Z. Lyon njoftoj z. Balijs për planet afatgjate të ATTF dhe Ministrisë së Luksemburg për rajonin e Ballkanit Perëndimorë në aspektin afatmesem dhe afatgjatë. Shoqata e Bankave të Kosoves tanime ka realizuar një numer të trajnimeve të nivelit të lartë në bashkëpunim me ATTF dhe ka planifikuar një program trajnimesh për vitin 2016 i cili do të realizohet me mbështetje të bankave komerciale në Kosovë. Në takim ishte prezent edhe z. Arben Salihu, Menaxher për trajnime në SHBK.



## Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive diskutohet në Shoqatën e Bankave të Kosovës

Sot, më 2 Mars 2016, Shoqata e Bankave të Kosovës është takuar me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) për të diskutuar mbi mundësinë e kësaj agjencie për të mbështetur Fondin Kosovar të Garantimit të Kredive të themeluar me Ligjin përkatës dhe të miratuar në Kuvend disa muaj më parë. Me këtë rast Z. Petrit Balija, Drejtor Ekzekutiv i SHBK-së, i dha mbështetje të plotë themelimit të këtij Fondi i cili mbështetet edhe nga organizata tjera si USAID, Banka Gjermane për Zhvillim, Qeveria Zvicerane dhe Ministria Tregëtisë dhe Industrisë. Z. Balija tha se me



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE  
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

ndihmën e bankave komerciale të Kosovës qëllimet e këtij fondi mund të jetësohen për ti dhënë mundësi më të mëdha bizneseve të Kosovës për qasje më të madhe në financa.

## Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, takoi Shoqatën e Bankave të Kosovës



Ministrja Hykmete Bajrami priti sot në takim Bordin e Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës. Ministrja Bajrami në fillim të takimit theksoi se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është e përkushtuar për bashkëpunim me sektorin bankar në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit në vend. Ministrja Bajrami po ashtu me theks të veçantë përmendi nevojën e një komunikimi të drejtëpërdrejt mes MTI-së dhe Shoqatës së Bankave për të gjitha sfidat që dalin gjatë punës në sfera të ndryshme të këtij sektori.

Kryetari i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe ngriti disa çështje lidhur me

regjistrin elektronik të pengut. Ai potencoi rëndësinë e madhe që ka për bankat ky regjistër dhe kërkoi që politikat e MTI-së sa i përket këtij regjistri të jenë në përputhje me nevojat e bankave dhe klientëve të tyre.

Ministrja premtoi që po punohet që sa më shpejt të zgjidhen të gjitha çështjet për të cilat Shoqata shprehu shqetësim dhe të dyja palët u pajtuan që një bashkëpunim i tillë mes MTI-së dhe Shoqatës së Bankave të vazhdojë në mënyrë që sistemi bankar të funksionojë pa pengesa duke qenë gjithmonë në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve.

*Burimi: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*

## Shoqata e Bankave të Kosovës merr pjesë në konferencën “Financimi i Kontratave dhe Efiçenca në Pagesa në tregun e Kosovës”



Drejtori ekzekutiv i SHBK-së, z. Petrit Balija mori pjesë në panelin e konferencës “Financimi i Kontratave dhe Efiçenca në Pagesa në tregun e Kosovës” e organizuar me datën 31 Mars, 2016. Konferenca trajtoi temën e financimit të kontratave përmes faktoringut financiar si dhe efiçencën e pagesave në tregun e Kosovës.

Me këtë rast duke përmendur uljen drastike të normës së intersit për kredi si dhe përmirësimin e kushteve tjera të huamarrjes në Kosovë, z. Balija tha “Financimi përmes faktoringut është një temë mjaft e qëlluar për këtë tryezë pasi që nuk është trajtuar ende mjaftueshëm në Kosovë dhe paraqet një mundësi shtesë për finanimin e bizneseve të Kosovës e në veçanti bizneseve të cilat kanë nevoja sezonale për mbështetje financiare. Megjithatë, për të pasë sukses faktoringu financiar, ekzistojnë një numër reformash që duhet ndërmarrë në ambientin e të bërit biznes në Kosovë.”

Z. Balija listoj një sërë faktorësh të cilët duhet të përmirësohen siq janë: sigurimi i produkteve agrare nga agrobiznesi, përmirësimi i zbatimit të kontratave dhe rritja e numrit të përmbauesve privat, njohja më e mirë e kamatvonesës nga gjyqësori në Kosovë, si dhe rekomandoi që faktoringu në Kosovë duhet të fillojë në formën graduale ku mund të aplikohet Hipoteka Mix e cila, siç sqaroi ai, është një kombinim i kolateralizimit të kontratave duke përfshirë këtu edhe faktoringun.

Në panelin e kësaj konference mori pjesë edhe zv/drejtoresha e bankes ProCredit, znj. Eriola Biboli e cila përmendi disa nga përmirësimet e sistemit bankar që janë shënuar në vitet e fundit dhe poashtu elaboroi përvojat e Procredit Bank në lidhje me temën në fjalë. Kjo konferencë u organizua nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës ndërsa pjesëmarrës ishin akterët kyq nga USAID, KIESA dhe përfaqësues nga sektori bankar.

<http://www.rrokum.tv/ekonomi/pse-ska-kredi-per-prodhuesit-vendore/>



## JAVA NDËRKOMBËTARE E PARASË 2016 “Merr pjesë, kurse në mënyrë të mençur!” (Take part, save smart!)



**14 mars 2016, Prishtinë, Kosovë** – Shoqata e Bankave të Kosovës, nga data 14 mars deri më datën 18 mars 2016 do të jetë nikoqir i aktiviteteve të ndryshme për të shënuar Javën Ndërkombëtare të Parasë. SHBK në kuadër të aktiviteteve të saja edukativo-financiare organizon ligjerata, orë mësimore dhe aktivitete të ndryshme për fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme dhe studentët në disa qendra të Kosovës (Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Mitrovicë). Ky aktivitet është i organizuar në 124 vende të botës ndërsa koordinohet në nivel botëror nga Organizata Financiare për Fëmijë dhe të Rinjë (Child & Youth Finance International), organizatë jo-profitabile me seli në Amsterdam. Në Kosovë ky aktivitet vjen i organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Aktivitetet përfshijnë punëtori me fëmijë, të rinjë dhe studentë në fushën e menaxhimit të parasë, kursimeve, menaxhimi i financave personale. Qëllimi kryesor i shënimit të kësaj jave është fuqizimi i gjeneratave të reja, që të marrin njohuri ekonomike-financiare nga ekspertë të sistemit bankar dhe rrjedhimisht të jenë të përgjegjshëm me financat e tyre.

Aktivitetet do të organizohen gjatë tërë javes në këto qendra:

- 14 mars 2016 –ligjeratë për kursimet me nxënësit e shkolles fillore “Model” në Prishtinë
- 15 mars 2016 –do të mbahet ligjeratë për kursimet me nxënësit e shkolles fillore “Selami Hallaçi” në Gjilan,
- 16 mars 2016 –do të mbahet punëtori rreth kursimeve, shpenzimeve, investimeve dhe menaxhimit të parasë me nxënësit e Shkolles së Mesme profesionale “Ali Hadri” në Pejë,
- 17 mars 2016 –ligjeratë për paranë dhe kursimet në shkollën International School of Prishtina (ISP)
- 18 mars 2016 –do të mbahet punëtori për kursimet, shpenzimet, investimet, dhe menaxhimi i financave personale me studentët e Kolegjit Ndërkombëtar në Mitrovicë (IBCM).





## Shoqata e Bankave të Kosovës dhe IFC-ja i bashkojnë përpjekjet për t'i përforcuar Institucionet Financiare dhe për ta Inkurajuar Inovacionin

IFC-ja, anëtare e World Bank Group, në partneritet me Shoqatën e Bankave të Kosovës do ta mbështesë sistemin vendor të shërbimeve bankare për t'i përforcuar sistemet relevante të menaxhimit të rrezikut, do të asistojë në përmirësimin e menaxhimit të kredive jo-performuese dhe në përmirësimin e shërbimeve bankare për sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) përmes trajnimeve dhe punëtorive. Ceremonia e sotme e nënshkrimit bëhet për ta festuar fillimin e këtij bashkëpunimi.

“Angazhimi i IFC-së në sektorin financiar të Kosovës dhe të rajonit më të gjerë të Ballkanit mbetet prioritet strategjik dhe përfshinë një kombinim të investimeve dhe shërbimeve këshilluese,” tha Thomas Lubeck, Menaxher Rajonal i IFC-së për Ballkanin Perëndimor. “Nën këtë bashkëpunim ne do të sjellim njohuri globale dhe do të ndërtojmë mbi përvojën

vendore të partnerit tonë Shoqatës së Bankave të Kosovës për t'i dhënë këshillat e synuara.” Deri në qershor 2017, IFC-ja dhe Shoqata e Bankave të Kosovës do t'i mbajnë një seri të trajnimeve dhe punëtorive që mbulojnë menaxhimin e rrezikut, rrezikun operacional, likuiditetin, zgjidhjen për asetet e konfiskuara për shkak të kredive të papaguara dhe shërbimet bankare për segmentit NVM.

“Shoqata e Bankave të Kosovës ka pasur një bashkëpunim të mirë me IFC-në në disa fusha të ndryshme, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të sektorit bankar. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit do t'i mundësojë sektorit bankar që të ketë qasje në një numër të trajnimeve në disa nga temat më të rëndësishme për këtë sektor”tha z. Petrit Balijs, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës.



## Shoqata e Bankave të Kosovës dhe Banka Qëndrore e Kosoves diskutuan mbi progresin e arritur në implementimin e standardeve të Bazel-it

Sot, më 2 shkurt, 2016 në vazhden e takimeve në kuadër të projektit për implementimin e standardeve të Bazel-it u mbajt takimi konsultativ mes Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Bankës Qëndrore të Kosovës (BQK). Në këtë takim sektori bankar u përfaqësua nga drejtori ekzekutiv z. Petrit Balijs

dhe kryetari i Komitetit të Riskut në SHBK z. Gem Maloku, ndërsa nga ana e BQK-së prezent në takim ishin z. Ralf Raab këshilltar i lartë pranë departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK dhe z. Amir Zylfiu nga mbikëqyrja bankare në BQK.



## SHBK merr pjesë në punimet e Konferencës Rajonale “Iniciativa për implementimin e shtyllës së dytë të kornizës rregullative të Basel-it: ICAAP/SREP dhe shembujt praktik”

Prej dates 20-22 janar 2016, në Prishtinë zhvilloi punimet Konferenca e parë rajonale me titull “Iniciativa për implementimin e shtyllës së dytë të kornizës rregullative të Basel-it: ICAAP/SREP dhe shembujt praktik”.

Konferenca rajonale është mbajtur në kuadër të projektit të BQK-së për implementimin e kornizës së Basel-it për Mbikëqyrjen e Bankave, i mbështetur nga GIZ. Këto standarde kanë për qëllim të krijojnë standarde të unifikuara ndërkombëtare për mbikëqyrjen e bankave ndërsa janë të përgatitura nga Komiteti i Basel-it për Mbikëqyrjen e Bankave në kuadër të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare me Seli në Basel të Zvicrrës.

Në hapje të konferencës mbajti një fjalim edhe kryetari i bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Ilir Aliu. Ai e cilësoi këtë nismë si një hap mjaft të rëndësishëm drejt përmirësimit të perspektives rregullatore, si dhe përafrimit të standardeve të mbikëqyrjes bankare me standardet e BE-së. Ai gjithashtu tha se tema e konferencës ka qëllim të dyfishtë për bankat komerciale si thirrje për bankat komerciale që të reflektojnë mbi standardet e tyre të operimit si dhe është një ftesë që të përafrojnë praktikën e tyre me praktikën më të mirë nga vendet e BE-së.

Z. Aliu përmendi mësimin që si banka kanë nxjerrë nga kriza financiare e që është se në parim çdo bankë duhet të jetë fleksibile dhe e përgatitur për të përballuar rreziqet e papritura, dhe jo vetëm për shkak se rregullatorët kërkojnë atë, por sepse kjo është e natyrshme në standardin bankar etik.

Arritja e objektivave të procesit ICAAP dhe implementimi i saj është në interesin e sektorit bankar. Në mjedisin e sotëm është e domosdoshme që të definojmë saktësisht,



të kuptojmë, të matim dhe të monitorojmë rrezikun dhe nivelet e kapitalit. Prandaj, projekti ICAAP është i mirëseardhur dhe mbështetur nga industria bankare në Kosovë.

Ne e vlerësojmë lartë fleksibilitetin e treguar në implementimin hap pas hapi të këtij projekti, si dhe e konsiderojmë shumë të rëndësishme kohën e alokuar për bankat komerciale që të përgatisin vlerësimin e tyre për implementimin e ICAAP. Tutje, z. Aliu shtoi se dialogu i suksesshem në mes të BQK-së, Shoqatës së Bankave si dhe bankave komerciale do të jetë çelësi për një zbatim të suksesshem të projektit ICAAP. Shpresoj që me zbatimin e një instrumenti kaq të rëndësishëm të menaxhimit të kapitalit, sektori bankar në Kosovë do të jetë në gjendje shumë më të mirë që të përballojë çfarëdo goditje apo skenarë të tjerë, dhe është detyra jonë, si menaxher të bankës që të arrijmë këtë, u shpreh Z. Aliu në përfundim të fjalimit dhe në hapje të diskutimit të panelit të ekspertëve.

Të ftuar në këtë konferencë ishin edhe përfaqësuesit tjerë nga bankat, ku gjatë punimeve të kësaj Konferencë prezantuan praktikën e tyre. Një nga prezantuesit e Shoqatës së Bankave ishte edhe z. Gem Maloku, kryetar i Komitetit të Riskut në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

## Banka Ekonomike vazhdon me seminarët e Edukimit Financiar për klientë



Në vazhden e prezentimeve pranë klientëve për "Edukim Financiar", Banka Ekonomike ka mbajtur ligjeratë mbi këtë temë në qytetin e Gjilanit, Ferizajit dhe Mitrovicës, prezentim ky i cili ka për qëllim të rris edukimin financiar të klientëve duke i bërë ata klientë proaktiv në menaxhimin e financave personale, kuptojnë karakteristikat

e produkteve bankare dhe rrjedhimisht të bëjnë huazim të mençur. Banka Ekonomike do të vazhdojë organizimin e ligjeratave të tilla edhe në qendrat tjera të vendit.

Banka Ekonomike  
Mendon për ty!

## JCR Eurasia Rating rivlerëson BKT me AAA (Alb) për të tetën herë radhazi



Edhe ky vit, më saktësisht data 20 Qershor, 2016, i solli BKT-së çmim për të tetën herë radhazi nga JCR Eurasia Rating. BKT u rivlerësua me notën 'AAA (Alb)' dhe me një situatë "të qëndrueshme" në terma afatgjatë në nivel kombëtar, që tregon nivelin më të lartë të investimit.

JCR-ER ka vërejtur se BKT ka dominuar tregun duke zotëruar 25,90% të tij, duke e bërë bankën më të madhe në Shqipëri. Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, treguesit e përfitueshmërisë mbi mesataren e sektorit, baza shumë e gjerë e depozitave, rritja mbi mesataren e sektorit dhe rritja e pjesës së tregut janë faktorët kryesorë që e diferencojnë BKT-

në nga sektori në një drejtim pozitiv dhe mbështetës kundrejt të gjitha vlerësimeve të dhëna.

Për këto arritje, gjatë viteve 2006 - 2016, BKT është nderuar me një numër çmimesh kombëtare dhe ndërkombëtare nga institucione financiare prestigjioze, ndër të cilat disa herë si "Banka më e mirë e vitit në Shqipëri", "Banka më e mire në Shqipëri", dhe "Banka më e mirë në Evropën Juglindore". Çmimet që BKT ka pranuar nga institucionet e shumta prestigjioze financiare janë një tjetër dëshmi e vlefshmërisë së strategjive të saj.

## BPB mëson fëmijët mbi kursimet dhe vlerën e parasë

BPB me datë 1 qershor, për nder të 'Ditës ndërkombëtare të fëmijëve', ftoi fëmijët parashkollorë së bashku me prindërit e tyre në degët e saj në Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Pejë. Kjo ngjarje kishte karakter argëtimi, socializmi dhe informimi, me ç'rast patën rast për t'u njoftuar për së afërmi me punën që e bën banka jonë përmes një prezantimi të shkurtër mbi kursimet me synim që të ushqejmë tek fëmijët ndjenjën e kujdesit për paratë dhe rritjes së edukimit financiar tek brezi i ri. Pra, qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ishte që fëmijëve t'u prezantojmë konceptet bazë për paratë në fëmijëri të hershme kur fillojnë të krijojnë idenë e monedhave

dhe fillojnë t'i vendosin në arkat e tyre të kursimit. Gjithashtu, gjatë këtij aktiviteti shfrytëzuam rastin t'i gëzojmë fëmijët me disa dhurata simolike.



## NLB Banka përkrahë financiarisht renovimin në dy kate në Spitalin e Pediatriisë

Kryetari i Bordit Udhëheqës të NLB Banka, zotëri Albert Lumezi, sot mori pjesë në ceremoninë inauguruese të renovimit në dy kate në Spitalin e Pediatriisë përkatësisht të reparteve të Neurologjisë psikiatrike, Hematologjisë me Onkologji, Gjenetikës si dhe të repartit të Gastroenterologjisë (rastet kronike dhe rastet akute).

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: Zëvendës Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, Dr. Izet Sadiku, Drejtori i Klinikës Pediatrike, Dr. Muharrem Avdiu, Kryetari i Bordit Udhëheqës të NLB Banka, z. Albert Lumezi si dhe pjesëmarrës tjerë nga QKUK dhe NLB Banka. "Të gjithë jemi dëshmitar për gjendjen e sistemit e shëndetësor në vendin tonë si dhe kushtet e vështira të punës, kështuqë NLB Banka ka vendosur që të ndihmoj komunitetin ku vepron, në mënyrë që të kontribuojë sado pak për përmirësimin



e kushteve në përgjithësi, e në veçanti në sistemin shëndetësor", tha Kryetari i Bordit Udhëheqës të NLB Banka, zotëri Albert Lumezi.

## Banka ProCredit edhe këtë vit mbështetëse e DOKUFEST

Edhe këtë vit për të 12-tinë me radhë, banka ProCredit ka konfirmuar mbështetjen e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar – Dokufest, si sponsor gjeneral i kësaj ngjarje të rëndësishme kulturore në vend. Pas 15 vjetësh të mbajtjes së këtij festivali, DokuFest është ngjarja më e madhe kulturore në vend dhe një ndër 25 festivalet më të mira të filmit dokumentar në botë.

Edicioni i sivjetmë i Dokufest fillon më 05 gusht dhe do të zgjas deri më 13 gusht në qytetin historik dhe piktoresk të Prizrenit, gjatë së cilit do të shfaqen më shumë se 200 filma nga vende të ndryshme të botës në 6 programe garuese dhe një numër të

programeve speciale. Kjo ngjarje kulturore tërheq vëmendjen e një numri të madh artistësh, film bërësve, producentëve dhe artdashësve nga rajoni dhe bota.

"Banka ProCredit si një institucion që vazhdimisht mbështet ngjarjet e mirëfillta në Kosovë e posaçërisht ato që kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në zhvillimin e kulturës, ka besuar në DokuFest që nga vitet e para, duke qenë një ndër mbështetësit kryesor për 12 vjet radhazi" tha Albena Çarkaxhiu menaxhere e departamentit të Marketingut dhe PR në ProCredit Bank.



## Euromoney: Raiffeisen, Banka më e mirë në Kosovë



Prishtinë, 7 korrik 2016 - Revista financiare britanike Euromoney e ka vlerësuar Bankën Raiffeisen me çmimin "Banka më e mirë në Kosovë" për vitin 2016. Ky çmim është bërë publik në një ceremony solemne të mbajtur në Londër, të mërkurën me datë 6 korrik 2016. Përveç Bankës Raiffeisen në Kosovë, edhe bankat e rrjetit të RBI në Rumani, Rusi, Serbi dhe Sllovaki janë vlerësuar si bankat më të mira në vendet ku veprojnë. "Jemi shumë krenarë që e kemi fituar edhe këtë çmim dhe e shohim si një vlerësim i pavarur dhe konfirmim i qasjes sonë afariste në Kosovë duke e vendosur klientin në qendër të vëmendjes. Vlerat tona qenësore: besueshmëria, transparenca, shërbimi dhe qëndrueshmëria kanë bërë që të jemi banka më e mirë në Kosovë.

Duke qenë banka më e mirë, arritëm të bëhemi edhe Banka numër një në vend duke pasur më shumë kredi, depozita, degë dhe klientë sesa bankat tjera" tha Robert Wright, drejtor ekzekutiv i Bankës Raiffeisen në Kosovë. Çmimi i Euromoney është çmimi i dytë që Banka Raiffeisen në Kosovë e ka pranuar gjatë këtij viti për gamën e gjerë të shërbimeve dhe produkteve bankare që e ofron për klientët e saj individë dhe biznese në Kosovë. Në prill 2016, EMEA Finance, një tjetër revistë britanike - e specializuar në mbulimin e aktiviteteve të industrisë financiare në Evropë, Lindjen e mesme dhe Afrikë - e ka vlerësuar Bankën Raiffeisen në Kosovë në kuadër të çmimeve për bankat më të mira në vendet europiane "Europe Banking Awards 2015".

## TEB Sh. A. Banka më e mirë në Kosovë nga Global Finance

Çdo vit, Global Finance përzgjedh institucionet më të mira financiare në botë. Këto shpërblime janë të njohura ndërkombëtarisht dhe të besueshme. TEB Sh. A. ka ndërtuar reputacionin e ekselencës nëpërmjet zbulimit të produkteve inovative dhe shërbimeve shembull për njerëzit. Ky vlerësim si Banka më e mirë në Kosovë vjen nga publikimi prestigjioz i revistës, Global Finance Magazine. Ky shpërblim është arritje e jashtme e Bankës tonë dhe

të arriturave të saj. Këto shpërblime janë matje të rëndësishme të performansës tonë, përkushtimit dhe reputacionit të njohjes së standardeve ndërkombëtare. TEB SH. A. dëshiron të falënderojë të gjithë klientët, stafin, partnerët e biznesit dhe aksionarët për kontributin e tyre në performansën e përgjithshme të Bankës që ka rezultuar me një shpërblim të tillë prestigjioz.



## Publikimet e Shoqatës së Bankave të Kosovës

**“The Kosovo Banker”** është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë saktë publikun lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faja

Shoqatës së Bankave të Kosovës  
[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com).

Revistat e botuara:



**“Vështrimi Periodik mbi Sektorin Financiar të Kosovës”** është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë.

Çdo publikim mujor do të trajtojë çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore do të kenë sektorin bankar në Kosovë.  
[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com).

Publikimet mujore të publikuara deri më tani:

### Viti 2014

### Viti 2015

### Viti 2016





BKT MOBILE



TRANSFERTAT



LLOGARITË



KARTAT E KREDITIT



INVESTIMET



PAGESAT



FATURAT



038 666 666 | www.bkt-ks.com

ME NJË KLIK HYNË NË BOTËN E  
BKT MOBILE BANKING

Ne jemi gjithmonë këtu!